

RAPORTI

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit BSc në “Infermieri”

Universiteti Privat “Albanian University”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof.As. Vjollca Durro

Dr. Niko Hyka



(Tetor 2019)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit BSc. Infermieri

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Privat "Albanian University"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i shkencave Mjekësore
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	UMASh Nr. 411, datë 25.08.2011
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të pare	Vendim BA Nr. 31, datë 19.05.2017
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në "Infermieri"
6	Cikli i studimit:	Cikli i parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite/6 semestra
8	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	6
16	Nr i studentëve	420 studentë

Përmbajtje:

HYRJE	4
GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ).....	4
DISKUTIME DHE KOMENTE MBI DRAFTIN E PARË TË RAPORTIT	Error! Bookmark not defined.
ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA BORDI I AKREDITIMIT NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË.....	9
VLERËSIMI I NJËSISË NË SHËRBIM TE PROGRAMIT TË STUDIMIT	10
POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE.....	28
KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.....	39
ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT.....	42
SUMMARY ANALYSES OF THE STUDY PROGRAM EVALUATION.....	44
ANEKSE.....	46



HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Infermieri

Programi i studimit Bachelor në Infermieri është hapur me UMASH nr.411 datë 25.08.2011. Programi Bsc në Infermieri u akreditua me kusht me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit me nr.239, datë 09.05.2016 bazuar në vendimin nr.151 date 31.03.2016 të Këshillit të Akreditimit. Institucioni në vitin 2017 ka dorëzuar dokumentacion për heqjen e kushteve të akreditimit me shkresë Nr. Prot 370/1, datë 03.11.2017, në baze të këtij dokumentacioni por dhe vizitës të realizuar në institucion në vitin 2017, Bordi i Akreditimit me vendim Nr 31, datë 19.05.2017, vendosi akreditimin për herë të parë të programit të studimit Bsc në Infermieri për dy vite akademike me vlefshmëri deri në 31.07.2019. Me vendim të Rektoratit të AU, nr.prot 51/2, datë 09.03.2016, programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë i cili është aktualisht përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit akademik në funksion të programit të studimit.

Programi ka pësuar ndryshime në vite ku më i fundit është miratuar me VS 15, datë 25.04.2018 dhe konfirmuar nga MASR me shkresë nr.prot. 4932, datë 05.06.2019. Këto ndryshime janë bërë në masën 6.6 % dhe reflektojnë detyrimet që lindin nga zbatimi i VKM. 41, datë 24.01.2018¹

Pas mbylljes së Filialit të Beratit të AU, në këtë program studimi janë transferuar të gjithë studentët që kanë studiuar në këtë program studimi (BSc. Infermieri në Filialin e Beratit është vlerësuar me VKA Nr. 211, datë 29.07.2011, licensuar me UMASH Nr. 411, datë 25.08.2011, dhe akredituar me UMASH Nr. 274, datë 02.07.2013)

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Grupi i vlerësimit është ngritur nga ASCAL dhe miratuar nga Bordi i Administrimit.

GVJ është përbërë nga: Prof.As. Vjollca Durro dhe Dr. Niko Hyka, si ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi. Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL: Znj. Xhiliola Bixheku.

Vizitat në institucion janë realizuar në datat 19 dhe 20 Qershor. Grupi i vlerësimit shpreh konsideratën maksimale për angazhimin e institucionit në këtë proces: para vizitës, gjatë përgatitjes të dokumentacionit të vlerësimit dhe gjatë vizitës në institucion.

GVJ falenderon drejtuesit e njësisë kryesore, njësisë bazë dhe koordinatorin institucional për menaxhimin e procesit nga ana e institucionit. Po ashtu, GVJ falenderon koordinatorin teknik të ASCAL dhe institucionin në tërësi për profesionalizmin e treguar gjatë gjithë këtij procesi.

Me datë 16.09.2019 dërgohet në Institucion Draft Raporti i Vlerësimit të jashtëm i Hartuar nga ekspertet e vlerësimit. Më datë 20.09.2019 Institucioni sjell në ASCAL komentet në lidhje me Draft – RVJ. Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

¹ Informacion i detajuar në përmbajtje të RVJ, seksioni i programit të studimit

1. Konstatimi i GVJ:

Fusha 3, Pjesa Përshkrimore, fq.8-9:

“Nuk është paraqitur sa orë mësimore ka çdo vit, bazuar në numri e grupeve të studenteve. GVJ nuk mund të analizojë përpuethshmërinë midis orëve të planifikuara në program me shpërndarjen individuale tek personeli akademik” “Në dokumentacion e vënë në dispozicion të GVJ, është paraqitur ngarkesa mësimore në orë që mbulojnë pedagogët e përfshirë në program dhe Departament po jo sa kredite nga programi mbulon cdo pedagog”

Komenti i IAL mbi vëretjen:

“Orët mësimore të planifikuara janë pasqyruar qartë në kurrikulën e programit të studimit në Bachelor Infermieri (Aneksi A.9). Ndërsa orët mësimore në total që mbulon çdo pedagog janë pasqyruar në tabelën 13 të RVB-së, llogaritja e të cilave është bërë duke shumëzuar orët e kurrikulës me grupet e studentëve për secilin vit. Bashkëlidhur ju ri-dërgojmë ngarkesën që stafi akademik mbulon në programin Bachelor “Infermieri”, si dhe në programe të tjera studimi ku janë angazhuar. (Evidencë Nr. 1)”

Pergjigja e GVJ mbi komentin:

Ngarkesa mësimore sipas dokumentacionin të vënë në dispozicion është llogaritur në orë dhe kredite për çdo vit akademik, por nuk është paraqitur në total sa orë mësimore ka çdo vit, bazuar në numrin e grupeve të studentëve. GVJ nuk mund të analizojë përpuethshmërinë midis orëve të planifikuara në program me shpërndarjen individuale tek personeli akademik.

Psh Në një lëndë të caktuar me 6 ETC/47 orë mësimore (sipas programit) janë realizuar 180 orë mësimore nga tre petagogë(30/120/30). GVJ nuk mund të llogarisë sa grupe apo kredite ka realizuar çdo petagog. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

2. Konstatimi i GVJ:

Fusha 3, Pjesa Përshkrimore, fq.8-9:

“U konstatuan raste kur një pedagog mbulon më shume se tre lëndë në program, Personeli S.B mbulon 4 lëndë dhe D.Xh 4 lëndë”

Komenti i IAL mbi vëretjen:

“Personeli akademik S.B ka zhvilluar tre module të të njëjtës lëndë, përkatësisht “Sëmundje të brendshme” “Infermieristika e sëmundjeve të brendshme” “Geriatri”, Pra bëhet fjalë për një lëndë të vetme. Personeli akademik D.Xh ka zhvilluar dy module të të njëjtës lëndë, përkatësisht “Mikrobiologji” dhe “Sëmundje infektive” që përbëjnë një lëndë të vetme, si dhe dy lëndë të tjera “Anestezi reanimacion” dhe “Epidemiologji”, pra në total përbëjnë një angazhim në 3 lëndë.”

Pergjigja e GVJ mbi komentin:

GVJ, referuar RVJ, rishikoi dokumentacionin lidhur me modulet e përfshira në një lëndë dhe bie dakord me komentin e IAL. **Raporti në këtë pikë ndryshon.** GVJ i qëndron konstatimit të zhvillimit të lëndëve apo moduleve të vecanta nga petagogë specialiteti i të cilëve nuk përputhet me lëndën që ata zhvillojnë.

3. Konstatimi i GVJ:

Fusha 3, Pjesa Përshkrimore, fq.8-9:

“...llojet e kontratave që përdoren nga ana e institucionit për kategori të ndryshme të personelit akademik, dhe ishte e paqartë për GVJ, për të përcaktuar se mbi c’kriterë punonjës të ndryshëm mund të nënshkruanin kontrata të ndryshme”

Komenti i IAL mbi vëretjten:

“Bazuar në kategoritë e ndryshme të personelit akademik, kontratat janë hartuar dhe zbatohen mbi detyra dhe përgjegjësi përkatëse të personelit.”

Pwrgjigja e GVJ mbi komentin:

Referuar RVJ, GVJ konstaton se:

“Në diskutimin me pedagogët (takimi me personelin akademik) u konstatua se ata njihen paraprakisht me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga lidhja e kontratës së punës. Ata referuan se kontratat me institucionin janë kontrata me afat të pacaktuar ku pagesa rryhej në forma të ndryshme (pagesa kryhet në bazë të ngarkesës mësimore që ka pedagogu gjatë vitit akademik dhe pagesë mujore). **Llojet e kontratave që përdoren nga ana e institucionit për kategori të ndryshme të personelit akademik dhe ishte e paqartë për GVJ për të përcaktuar se mbi çkriterë punonjës të ndryshëm mund të nënshkruanin kontrata të ndryshme.** Në dosjet e personelit apo në dokumentet e vëna në dispozicion nga ana e institucionit (për këtë program studimi) janë përfshirë pjesërisht elementët e Udhëzimit nr.29, datë 10.09.2018, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, i cili përcakton mekanizmat për llogaritjen e ngarkesës vjetore të punës për personelin me kohë të plotë e të pjesëshme sipas kategorive të personelit akademik”

GVJ në këtë konkluzion arrin duke patur parasysh përcaktimet e neneve 58,59, 60 të LAL 80/2015, Udhëzimit 29. Dt.10.09.2018 dhe Std 3.1; 3.2 të ciklit të parë të studimeve në të cilat përcaktohen kategoritë e personelit akademik dhe statusi i tij në IAL. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

4. Konstatimi i GVJ:

Fusha 3, Konkluzione, fq.13:

“Në disa raste u evidentua mbingarkesë e personelit akademik përtej parashikimeve të udhëzimit 29, datë 10/09/2018” “Nuk ka një procedurë të përgjithshme për përcaktimin e detyrimeve akademike e administrative të personelit mbi bazën e së cilës të bëhet dhe vlerësimi i performancës së secilit pedagog”

Komenti i IAL mbi vëretjten:

“Albanian Univesity, duke u bazuar në udhëzimin 29, datë 10/09/2018, si dhe në Vendimin e Senatit Akademik (Aneksi 3.11 bashkëlidhur Raportit të RVB-së), parashikon që ngarkesa e pedagogëve të jetë në përputhje me nevojat e njëjësive bazë. Detyrimet akademike e administrative të secilit anëtar të personelit akademik janë të mirë përcaktuara në kontratën që secili disponon. Për vlerësimin e performancës së stafit akademik, Albanian University përdor metodologji të ndryshme. Drejtuesi i Departamentit pasi mbledh të dhënat nga pyetëtori i studenteve, fokus grupet, raportet e vetëvlerësimit të pedagogëve, formularin e deklarimit të aktiviteteve kërkimore shkencore, si dhe në bazë të angazhimit të pedagogut në detyra të tjera administrative, vlerëson performancën e secilit pedagog duke plotësuar formularin tip që AU disponon.”

Pergjigja e GVJ mbi komentin:

GVJ e njeh të drejtën e Institucionit referuar pikës 5 të udhëzimit nr 29. Datë 10.09.2018, dhe pikës 8 të nenit 59 të LAL 80/2015, për shpërndarjen e ngarkesës mësimore në bazë të nevojave (sic tregohet në rastet: personeli akademik me kohë të plotë R.XH 566/768.8 orë dhe E.K 563/669 orë dhe personeli akademik me kohë të pjesëshme A.G.J. 320/320 orë, E.P 135/135 orë, M.G.J. 150/210 orë,

N.C 180/255 orë, N.L 273/797.5 orë, M.XH 133/133 orë). Por për sa kohë institucioni nuk ka një procedurë të qartë të shpërndarjes së ngarkesës vjetore të punës në zbatim të udhëzimit të sipercituar (ngarkesa minimale, ngarkesa maksimale, ngarkesa e konvertuar për kërkim shkencor, punë administrative etj. Konstatimi i GVJ qëndron dhe **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

5. Konstatimi i GVJ:

“...Mungojnë të dhënat e sakta, raportet e auditimit, analiza financiare për të mbështetur këtë përfundim” “Ka të dhëna financiare të pjesshme të programit të studimit, por që janë të pamjaftueshme për të analizuar dhe gjykuar për ecurinë e programit dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të tij”

Komenti i IAL mbi vëretjeten:

“Albanian Univesity, ju dërgon bashkëlidhur raportin e auditimit të institucionit, në të cilin shprehen qartësisht të dhënat financiare mbi ecurinë dhe qëndrueshmërinë e të gjitha programeve të studimit. (Evidencë Nr. 2)”

Pergjigja e GVJ mbi komentin:

GVJ e vlerëson informacionin e vënë në dispozicion nga ana e institucionit, por ajo të cilës GVJ i referohet është analiza e qëndrueshmërisë financiare, pjesë e strategjisë së zhvillimit të programit e cila nuk është kryer. (Std 6.1, Std 2.5). Ky konstatim është pjesë e gjetjeve të GVJ dhe nuk është përfshirë në rekomandimet për insitucionin. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

6. Konstatimi i GVJ:

“Është e paqartë për GVJ-në, metodologjia e shpërndarjes së orëve për Kredit për veprimtaritë formuese”

Komenti i IAL mbi vëretjeten:

“Grupi i punës i ngritur për rishikimin e planit mësimor dhe elementëve që përbëjnë strukturën e programit është bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Konkretisht në VKM nr.41, dt. 24.01.2018 si dhe në Udhëzimin Nr.15, dt.04.04.2008, shtojca 1, pika 4, për shpërndarjen e krediteve brenda 1 disipline mësimore, si dhe pika 5, për ndarjen e orëve mësimore për 1 kredit ETCS (meqenëse VKM nr.41 nuk përcakton pikat 4 dhe 5, grupi i punës i është referuar Udhëzimit nr.15, i cili ishte akti ligjor në fuqi përpara daljes së VKM nr.41.) Konkretisht, 1 krediti ECTS i korrespondojnë 25 orë mësimore punë të studentit dhe ndarja e orëve mësimore të 1 krediti ECTS në orë për transmetim dijesh në auditor dhe orë për studim individual të studentit, sipas llojit të veprimtarive, është bazuar në Udhëzimin nr.15. Për detajet mbi metodologjinë e shpërndarjes së orëve për kredit për veprimtari formuese, Ju lutem referojuni Aneksit A.9, si edhe tabelës nr. 10 të raportit të Vlerësimit të Brëndshëm. Në kuadër të rishikimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të programit të studimiti, Albanian university mirëpret sygjerimin e GVJ-së.”


Pergjigja e GVJ mbi komentin:

Pas analizimit të evidencave shtesë dhe arsyetimit të IAL, GVJ është qartësuar për metodologjinë e shpërndarjes së orëve për Kredit për Veprimtaritë formuese. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**

7. Konstatimi i GVJ:

“Panvarsisht se niveli i studimit të këtij programi nuk kërkon angazhim të mirëfilltë shkencor, bie në sy angazhimi i ulët i njësisë përgjegjëse, në lidhje me projektet kërkimore shkencore si dhe mos fitimi i ndonjë projekti kërkimor në fushën e Infermieristikës...”

Komenti i IAL mbi vëretjeten:



“Edhe pse niveli i studimit të këtij programi nuk kërkon angazhim të mirëfilltë shkencor, Njësia Përgjegjëse ka ndërmarë hapa, edhe pse të vogla në angazhim konkret në fuhën e kërkimit shkencor. Është e vërtetë që deri më tani Njësia Përgjegjëse nuk disponon një projekt kërkimor të fituar, por është në përpjekje të vazhdueshme për te realizuar kërkime shkencore me karakter operacional.”

Përgjigja e GVJ mbi komentin:

GVJ vlereson përpjekjet e institucionit për shtimin e aktivitetit kërkimor shkencor, por në vlerësimin e programit i referohet arritjeve të deritanishme. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

8. Konstatimi i GVJ:

“Nuk ka një analizë të detajuar, mbi produktin apo efektshmërinë e këtyre marrëveshjeve, Fakulteti duhet të analizojë përfitimet për institucionin nga secili bashkëpunim për të parë vijueshmërinë ose jo në të ardhmen”

Komenti i IAL mbi vëretjten:

“Departamenti kryen në mënyrë periodike analizën mbi efektshmërinë e marrëveshjeve që disponon me institucione të ndryshme. (Evidencë Nr. 3)”

Përgjigja e GVJ mbi komentin:

Në evidencën nr 3, jepen marrëveshjet që insitucioni ka me inistitucione të ndryshme , GVJ i referohet një analize mbi efektshmërinë e këtyre marrëveshjeve. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**


RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PËR PROGRAMIN E STUDIMIT BSC. INFIERMIERI

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA BORDI I AKREDITIMIT NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

Referuar gjithë dokumentacionit të vënë në dispozicion (dokumentacioni i vlerësimit si dhe informacionet e vëna në dispozicion nga ASCAL nëpërmjet AMS), programi i studimit ka kaluar në disa faza vlerësimi në kuadër të akreditimit. Në paragrafet të mësipërm janë paraqitur këto hapa të cilat janë finalizuar me vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr 31, datë 19.05.2017 për akreditimin e programit të studimit Bsc në Infermieri me dy vite akademike dhe vlefshmëri deri në 31.07.2019. Programi i studimit fillimisht është akredituar me kusht duke i lënë detyrë institucionit të plotësojë një sërë kushtesh (të paraqitura në VKA. Nr.151, datë 31.03.2016).

Bazuar në procesin e vlerësimit në kuadër të plotësimit të kushteve (folloë-up) dhe raportit teknik në përmbajtje, të hartuar në përfundim të procesit, (datë 05.05.2017), rezulton se institucioni ka përmbushur kushtet e vëna.

Bazuar në Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr 31, datë 19.05.2017, nuk rezultojnë kushte të vëna për plotësim me afat apo pa afat dhe në këto kushte GVJ gjykon se institucioni nuk ka detyrime apo kushte për të plotësuar nga akreditimi i mëparshëm.



VLERËSIMI I NJËSISË NË SHËRBIM TE PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga gjetjet e konstatimet nga vizita në institucion, GVJ konstaton se Programi i studimit Bsc në Infermieri zhvillohet sipas misionit dhe strategjisë për zhvillim të AU. Objektivat e këtij programi studimi i mundësojnë studentëve që ndjekin këtë program të përfitojnë dije, aftësi dhe kompetenca profesionale në fushën e Infermierise në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Programi i studimit Bsc në Infermieri organizohet në kredite dhe module konform Ssitemit të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Bazuar ne RVB dhe dokumentacioni mbështetës objektivat e këtij programi studimi jane :

- Përgatitja e studentëve me aftësi për të ndërmare studime më të avancuara në fushën specifike të studimit.
- Përgatitja e studenteve me njohuri akademike të përgjithshme mbi fushën e infermierisë por edhe me njohuri specifike për disa fusha të shkencave mjekesore.

Duke analizuar kurrikulën e programi të studimit Bsc në Infermieri vërehet se studentët në përfundim të këtij programi studimi kanë mundesi qe në vitin e pare të marrin dije të përgjithshme sic janë lëndët e Anatomise, Bilogjise, Fiziologjisë dhe më pas në vitin e dytë dhe të tretë studentët zhvillojnë lënde me karakter specifik të cilat i japin programit tonin profesional të Infermierit.

Departamenti nëpërmjet programit synon zgjerimin e marrëveshjeve me Insitucione të tjera vendase dhe të huaja në kuader të zhvillimit të praktikave, forcimin dhe zgjerimin e bashkëpunimeve me Universitetet partnere si dhe kualifikimin e mëtejshëm të stafit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;	Referuar dokumenacionit mbështetës të RVB, GVJ konstaton se programi Bsc në Infermeri është hartuar konform misionit dhe qëllimeve të AU. Ky program ka një ndërthurje të dijeve teorike me ato praktike të cilat i mundësojnë studenteve aftësimin e tyre për të qënë konkurent në tregun e punës. Bazuar ne RVB, rezulton se ky program studimi është i bazuar mbi një studim tregu që në hapjen e tij dhe i shërben zhvillimit ekonomik të vendit. (evidenca 1.3, evidenca 1.4)
Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;	
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në	

përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.	
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Programi i studimit Bsc në Infermieri zhvillohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të AU. Me njohuritë e fituara në këtë cikël studimi, studentët kanë mundësi për studim të mëtejshëm në ciklet pasardhëse. Bazuar në informacionet e marra nga takimi me studentët, pas përfundimit të këtij programi, do kenë fituar njohuritë dhe kapacitet e nevojshme profesionale për trajtimin e problematikave të përgjithshme dhe specifike të fushës së infermierisë. (evidenca 1.1, takimi me studentët)</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Bazuar në studimin e tregut, të realizuar nga Departamenti Infermierise dhe Fizioterapisë, GVJ konstaton se ky program studimi me kurrikulen aktuale është në përputhje me strategjine dhe zhvillimin ekonomik të vendit duke synuar të përgatise Infermiere me aftësi praktike dhe teorike. Gjatë hartimit të këtij studimi tregu (evidenca 1.4), insitucioni ka marrë parasysh disa faktorë të cilet janë : mundësite e punësimit të studentëve ne tregun aktual , konkurenca me insitucionet si motra , numri i pranimeve , ofertën që paraqet në treg punëdhënësi etj.</p> <p>GVJ gjykon se IAL ose njësia përgjegjëse duhet të hartojë një studim më specifik duke marrë parasysh zhvillimet e reja të tegut të punës në fushën e infermieristikës, veçanërisht punësimit jashtë vendit të të diplomuarve.</p>
Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Bazuar në statutin e institucionit GVJ konstaton së ky program studimi nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe synon në konsolidimin e mëtejshem të vlerave kulturore duke përgatitur Infermiere jo vetem në kuadrin professional por dhe atë human.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> Programi i Studimit Bsc në Infermieri është i bazuar në një studim tregu dhe ka objektiva të përcaktuara në përputhje me misionin dhe objektivat e institucionit. Nisur nga kërkesat aktuale jashtë vendit për të diplomuar në fushën e infermieristikës, programi ka ecuri pozitive dhe është mjaft i kërkuar nga studentët. Megjithatë është i nevojshëm studimi i tregut të punës më specifik nga ana e njësisë përgjegjëse për programin e studimit me qëllim garantimin e 	

ecurisë afatgjatë të programit të studimit.

2. Ky program pajis studentet me dijet e nevojshme për ushtrimin e profesionit të infermierit dhe ndjekjen e cikleve pasardhëse.
3. Programi Bsc në Infermieri nuk bie ndësh me vlerat kulturore kombëtare dhe është në përputhje me strategjinë e AU.

2. Struktura Akadematike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Programi i Studimit Bsc në Infermieri është pjesë e departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë, Fakultetit të Shkencave Mjekësore, i cili në përbërje të tij ka dhe dy departamentet e tjerë, atë të Farmacisë dhe Stomatologjisë. Referuar tabelës nr 1 Fakulteti i Shkencave Mjekësore, për vitin akademik 2018-2019, ka në përbërje të tij 106 pedagogë si personel akademik me kohë të plotë dhe 73 pedagogë si personel akademik më kontratë. Nga ky staf akademik me kohë të plotë 6 rezultojnë me gradën Prof, 5 me gradën Prof As, 32 me gradën Dr, 47 me gradën Msc, 15 me gradën SPA, si dhe 1 Mastër Profesional, kurse sa i përket kualifikimeve të stafit me kontratë rezultojnë 10 pedagogë me gradën Prof, 17 me gradën Prof.As, 22 me gradën Dr, 13 me gradën Msc, 9 SPA si dhe 2 Master Profesional.

Nga analizimi i tabelës nr. 2, GVJ ve re se pjesa me e kualifikuar e stafit akademik për vitin 2018-2019, është pjesa e personelit me kontratë, megjithatë nëse i referohemi stafit të departamentit përgjegjës i cili realizon këtë program studimi, konstatohet se stafi akademik i disponon titujt dhe gradat përkatëse për realizimin e programi të studimit Bsc Infermieri.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit

Referuar evidencës nr. 2.4, rezulton se organigrama e Fakultetit të Shkencave Mjekësore përbehet nga organet vendimarrëse që janë Dekani, Dekanati dhe Asambleja e Personelit Akademik si dhe nga njësite bazë që janë Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Departamenti i Farmacisë dhe Departamenti i Stomatologjisë.

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

GVJ duke iu referuar RVB, konstaton mospërputhje të të dhënave sa i takon personelit akademik me kontrate. Në tabelën nr 1 në RVB, personeli akademik me kontrate për departamentin e Infermierisë dhe Fizioterapisë është deklaruar 43 pedagogë ndërsa në tabelën nr 2 numri i personelit akademik me kontratë rezulton 63 pedagogë. Megjithatë duke marrë për bazë tabelën nr 2 GVJ konstaton se Departamenti përgjegjës për programin e studimit Bsc Infermieri përbehet nga 52 PAE DHE 63 PAK. Nga analizimi i kësaj tabelën rezulton se stafi PAE përbehet nga 4 Prof, 2 Prof As, 10 Dr, 26 Msc, 9 Spa dhe 1 Mater Profesional.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti

PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Grupi i vlerësimit të jashtëm gjatë vizitës të kryer në ambientet e Fakultetit të Shkencave Mjeksores të Universitetit “Albanian University”, departamentin e “Infermierisë dhe Fizioterapisë” si dhe nga shqyrtimin i dokumentacionit të aplikimit siguroi informacionin e nevojshëm lidhur me stafin akademik dhe administrativ të përfshirë në programin e studimit “Bachelor” në Infermieri si dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në këtë program. Të dhënat në RVJ i përkasin aktivitetit akademik të këtij programi për 2 (dy) vitet akademike 2017-2019. Akreditimi i programit është kryer në vitin 2017 për një periudhë dy vjecare.

Në vitin akademik 2018-2019 në programin e studimit bachelor në “Infermieri” janë angazhuar në procesin mësimor 86 personel prej të cilëve 76 janë personel akademik dhe 11 personel administrativ, 3 prej të cilëve janë personel ndihmës administrativ (sekretare mësimore). Personeli akademik i përfshirë në këtë program studimi përbëhet nga 45 PAE dhe 31 PAK. Shumica e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie zotëron tituj dhe grada. Nga stafi akademik efektiv 3 (tre) kanë titullin Professor, 2 (dy) kanë titullin Professor Asc, 16 (gjashtëmbëdhjetë) kanë gradën Doktorë shkencash, 15 (pesëmbëdhjetë) janë me Mastër Shkencorë, 1 (një) mastër profesional, 8 (tetë) janë mjek specializantë.

Nga personeli akademik me kontrate 4 (katër) kanë titullin Professor, 7 (shtatë) kanë titullin Professor Asc, 12 (dymbëdhjetë) kanë gradën Doktorë shkencash, 3 (tre) janë me Mastër Shkencorë dhe 2 (dy) janë mjek specialist dhe 3 (tre) në proces doktorature).

Në vitin akademik 2017-2018, në programin e studimit bachelor për Infermieri, janë angazhuar në mësimdhënie 76 staf akademik prej të cilëve 37 janë PAE dhe 39 janë PAK. Nga stafi akademik efektiv 4 (katër) kanë titullin Professor, 2 (dy) kanë titullin Professor Asc, 10 (dhjetë) kanë gradën Doktorë shkencash, 10 (dhjetë) janë me Mastër Shkencorë, 9 (nëntë) janë mjek specializantë dhe 2 dy janë në proces doktorature.

Nga stafi akademik me kontrate 4 (katër) kanë titullin Professor, 7 (shtatë) kanë titullin Professor Asc, 16 (gjashtëmbëdhjetë) kanë gradën Doktorë shkencash, 3 (tre) janë me Mastër Shkencorë dhe 5 (pesë) janë mjek specialist dhe 4 (katër) në proces doktorature.

Raporti PAE/PAK në programin e studimit bachelor në Infermieri, për vitin akademik 2018-2019 është 45/31 e shprehur në përqindje janë respektivisht 59.2% me 40.8%. Raporti PAE/student është 76/816, afersisht 11 studentë mbulohen nga një pedagog.

Për vitin akademik 2017-18 raporti PAE/PAK në këtë program studimi është 37/39 e shprehur në përqindje janë respektivisht 48.7% dhe 51.3%. Raporti PAE/student është 76/758, 10 studentë mbulohen nga një pedagog.

Numri i stafit akademik është i njëjtë gjatë dy viteve 2017-2019 por ajo që bie në sy është ndryshimi i raportit PAE me PAK. Në vitin akademik 2018-19 ka shtim të sfatit akademik efektive me 8 (tetë) pedagogë të rinj të cilët kanë gradën Dr shkencash dhe Mastër shkencor.

Shpërndarja e ngarkesës mësimore është bazuar në ligjin 80/2015 për Arsimit e Lartë dhe Kërkimin Shkencor Neni 59 pika 8, udhëzimin nr.29, datë 10.09.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe miratohet në fillim të vitit akademik nga senati i universitetit. Gjatë vizitës në instucion na u vu në dispozicion raporti i Departamentit përgjegjës në lidhje me shpërndarjen e ngarkesës mësimore për vitin akademik 2017-2018 dhe 2018-2019 të miratuar me vendim të senatit akademik. Nr. 788/3 datë 11.10.2017 dhe 116/7 datë 15.02.2019.

Ngarkesa mësimore sipas dokumentacionin të vënë në dispozicion është llogaritur në orë dhe kredite për çdo vit akademik, por nuk është paraqitur në total sa orë mësimore ka çdo vit, bazuar në numrin e grupeve të studentëve. GVJ nuk mund të analizojë përpunshmërinë midis orëve të planifikuara në program me shpërndarjen individuale tek personeli akademik.

P.sh në vitin akademik 2018-2019 në program për 180 ETC janë 2005 orë mësimore, ndërsa ngarkesa mësimore që mbulojnë pedagogët në total për vitin 2018-2019 është rreth 10325 orë (bazuar në dokumentacionin e ngarkesës mësimore të pedagogëve).

Në raportin vjetor të departamentit referohet se ngarkesa mësimore në lëndë nuk është realizuar 100% për arsye të ndryshme (festa zyrtare, arsye personale të pedagogëve etj).

Në dokumentacionin e vënë në dispozicion të GVJ, është paraqitur ngarkesa mësimore në orë që mbulojnë pedagogët e përfshirë në program dhe departament, por jo sa kredite nga programi mbulon çdo pedagog. Në këtë mënyrë llogaritja e ngarkesës mësimore konstatohet se në këtë program studimi për vitin akademik 2018-2019, PAE mbulon 77.2 % të ngarkesës mësimore, ndërsa për vitin akademik 2017-18 PAE mbulojnë 73.2% të ngarkesës mësimore.

Ngarkesa e stafit akademik është brenda normativës të miratuar nga senati i Universitetit. Ngarkesa maksimale që mbulojnë pedagogët në këtë program është 2-3 lëndë që varion nga 16-566 orë mësimore.

Nga verifikimi i dokumentacionit (zyra e burimeve njerëzore) GVJ konstatoi se në disa lëndë mësimi zhvillohet nga pedagogë specialiteti i të cilëve nuk përputhet me lëndën që ata japin. PAE me profesionin mikrobiolog (D.Xh.) përveç lëndëve që përputhen me specialitetin që ka, jep edhe lëndën e pediatri, infermieristikë në pediatri, sëmundje infektive dhe reanimacion. PAE me profesion biolog (G.B dhe O.R) japin biokimi mjekësore, M.H biologe jep histologji, biokimi mjekësore, mikrobiologji. Në përgjithësi fusha e studimeve të personelit akademik përputhet me lëndët/modulet që ata mbulojnë. Edhe pse CV e personelit akademik efektiv nuk janë paraqitur në dosjen e vetëvlerësimit, (pasi janë dhënë vetëm CV e stafit akademik me kontratë), GVJ arriti në këtë konkluzion nga takimi me stafin akademik dhe pyetjet e adresuar ndaj tyre.

Bazuar në ligjin Nr 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar titullari i lëndës duhet të jetë i Kategorisë Profesor. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni në të gjitha lëndët e zhvilluara në këtë program titullari i lëndës është me titullin Profesor ose profesor i Asociuar. Me përjashtim të lëndës së sociologji dhe etikë që janë me gradën doktorë shkencash.

GVJ në sektorin e burimeve njerëzore u njoh gjithashtu me procedurën e rekrutimit të personelit dhe tipin e kontratës për të dy kategoritë e punonjësve akademike (PAE dhe PAK). Institucioni disponon rregullore të veçantë në lidhje me kriteret e kandidatëve dhe procedurën e rekrutimit të miratuar nga Universiteti. Kontratat me stafin akademik janë dy lloje. Për pedagogët me kohë të plotë kontrata me afat të pacaktuar dhe për ata që janë në pension kontratat rinovohet çdo vit. Gjithashtu lidhur me pagesën e stafit ka kontrata ku stafi efektiv paguhet për 12 muaj e vitit ose kontratë ku pedagogu paguhet në bazë të ngarkesës mësimore që ka gjatë vitit akademik.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Tabela 4)*

Programi i studimit “Bachelor” në Infermieri është përfshirë në Departamentin e “infermierisë dhe fizioterapisë” në Fakultetin e Shkencave Mjekësore ku bëjnë pjesë 45 (dyzetepesë) anëtarë personel akademik efektiv , 31(tridhjetënjë) anëtarë personel akademik me kontratë dhe 11 staf administrativë prej të cilëve 3 pesë janë staf ndihmës administrativë. Këto të dhëna janë pasquruar në tabelën 4 në aneks.

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabela 5)

Stafi akademik që mbulon programin “Bachelor” përbëhet kryesisht nga pedagogë me eksperiencë të gjatë në mësimdhënie dhe kualifikim të lartë profesional në fushat përkatëse.

Në vitin akademik 2018-2019 në programin e studimit bachelor në “Infermieri” janë angazhuar në procesin mësimor 76 staf akademik, 11 personel administrativë, 3 prej të cilëve janë personel ndihmës administrative(sekretare mësimore) në këtë program. Nga stafi akademik efektiv 3 (tre) kanë titullin Professor, 2 (dy) kanë titullin Professor Asc, 16 (gjashtëmbëdhjetë) kanë gradën Doktorë shkencash, 15 (pesëmëbëdhjetë) janë me Mastër Shkecorë, 1 (një) mastër profesional, 8 (tetë) janë mjek specializantë. Nga stafi akademik me kontrate 4 (katër) kanë titullin Professor, 7 (shtatë) kanë titullin Professor Asc, 12 (dymbëdhjetë) kanë gradën Doktorë shkencash, 3 (tre) janë me Mastër Shkecor dhe 2 (dy) janë mjek specialist dhe 3 (tre) në proces doktorature).

Të dhënat sipas seksit

Në personelin akademik efektiv të departamentit “Infermierisë dhe Fizioterapisë” raporti meshkuj/femra për vitin akademik 2018-19 është 12/37 për PAE dhe 11/20 për PAK. Vihet re një numër i lartë i pedagogëve femra të përfshira në këtë program.

Të dhëna sipas moshës së personelit

Në këtë program studimi moshë e personelit akademik efektiv është e re, 32 (tridhjetëedy) pedagogë efektivë janë të moshës nën 45 (dyzetepesë) vjeç, ndërsa në personelin akademik me kontratë, grup moshë që dominon është mbi 45 vjeç. Nga 31 pedagogë me kontratë 21 janë mbi moshën 45 vjeç.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore të institucionit GVJ u njoh me procedurat e rekrutimit të stafit, me modelet e kontratave të punës për PAE, PAK, stafin ndihmës etj. GVJ verifikoi dosjet e personelit akademik dhe ndihmës mësimor, kontratat e punës të stafit akademik efektiv dhe me kontratë. Rekrutimi i stafit në punë kryhet sipas akteve rregullatore të miratuar nga Universiteti Privat “Albanian University”. Në diskutimin me pedagogët u konstatua se ata njihen paraprakisht me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga lidhja e kontratës së punës. Ata referuan se kontratat me institucionin janë kontrata me afat të pacaktuar ku pagesa rryhej në formë të ndryshme (pagesa kryhet në bazë të ngarkesës mësimore që ka pedagogu gjatë vitit akademik dhe pagesë mujore). Llojet e kontratave që përdoren nga ana e institucionit për kategori të ndryshme të personelit akademik e ishte e paqartë për GVJ për të përcaktuar se mbi çkriteret punonjës të ndryshëm mund të nënshkruanin kontrata të ndryshme. Në dosjet e personelit apo në dokumentet e vëna në dispozicion nga ana e institucionit (për këtë program studimi) janë përfshirë pjesërisht elementët e Udhëzimit nr.29, datë 10.09.2018, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, i cili përcakton mekanizmat për llogaritjen e ngarkesës vjetore të punës për personelin me kohë të plotë e të pjesëshme sipas kategorive të personelit akademik. Për pedagogët në pension kontrata rinovohet në fillim të çdo viti akademik.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Në këtë program studimi janë 11 vetë staf administrativ, 10 prej të cilëve janë staf efektivë dhe një me kontratë. Staf i administrativ përbëhet nga staf ndihmës mësimor i cili kryhen praktikën laboratorike në auditor si dhe ndjek studentët gjatë kryerjes së praktikës profesionale jashtë auditorit. Grupi i vlerësimit u njoh me stafin ndihmës administrativ dhe ndihmës mësimor dhe konstatoi se ky staf i përmbush kriteret e kualifikimit dhe profesionalizmit që kërkohet në këto pozicione pune.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion në mënyrë rastësore u panë dokumente të tjera si dosje të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, kontratat e punës, programet mësimore, dokumente të shpërndarjes së ngarkesës mësimore të stafit akademik, sylabuset, regjistri i matrikullimit të studentëve, procesvervale të provimeve, dokumentacioni i rekrutimit të pedagogëve të rinj, procedura e rekrutimit të pedagogëve, etj.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT Standardi IIL1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Rekrutimi i stafit bëhet në bazë të kërkesave të njësisë bazë të cilat i paraqiten dekanit të fakultetit të shkencave mjekësore. Proçedurat e rekrutimit të personelit janë transparente, në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në statutin dhe rregulloren e institucionit. Institucioni bazohet në akte ligjore në fuqi për rekrutimin e stafit akademik.</p> <p>Stafi akademik i punësuar me kohë të plotë në programin e studimit bachelor në Infermieri për vitin 2018-19 përbën 59.2% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e tij ndërsa për vitin akademik 2017-18 përbën 48.7%. Staf i akademik me kohë të plotë për vitin akademik 2017-18 mbulon 73% të ngarkesës mësimore. Për vitin 2018-2019 mbulon 77.2% të ngarkesës mësimore. Nga verifikimet e kryera, ka raste kur ngarkesa e personelit akademik efektiv tejkalon parashikimet e udhëzimit të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë, nr.29, datë 10.09.2018, i ndryshuar.</p> <p>Proçedurat ligjore për vlerësimin e personelit janë të përcaktuara në statutin dhe rregulloren e FSHM dhe të miratura nga senati akademik. Praktika e vlerësimit dhe formularët e performancës janë të miratura nga senati akademik. Proçedura e vlerësimit është transparente dhe bazohet në pyetësorët e studentëve, asistimin në orët e mësimit dhe vlerësimin nga shefi i departamentit në bazë të disa treguesve si: realizimin e ngarkesës mësimore të normuar, punën kërkimore-shkencore, kualifikimin,</p>

	pjesmarrjen në konferenca dhe referimin në to, planin e botimeve etj.
Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent,,.</p>	<p>Institucioni disponon bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit dhe kordinatorit për organizimin e programit të studimit, i cili është përgjegjësi i departamentit të infermierisë dhe fizioterapisë. Kjo bazë të dhënash gjendet pranë zyrës së Burimeve Njerëzore në dosjet personale të stafit akademik. (dokumentacioni u verifikua ne mënyrë rastësore).</p> <p>Institucioni (koordinatori i programit) disponon listën e plotë të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, të personelit ndihmës mësimor-shkencor, ngarkesën e tyre mësimore si dhe listën e personelit administrative, për çdo vit akademik dhe sipas semestrave.</p> <p>Kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik, të përcaktuara nga institucioni janë të publikuara në median e shkruar dhe elektronike. Proçedura u verifikua nga dokumetacioni që na u vu në dispozicion dhe nga takimet e realizuara me titullarët dhe stafin e burimeve njerzore.</p> <p>Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, titullari i lëndëve që ka programi i studimit, ka titullin profesor i Asc ose profesor dhe në dy lëndë doktor shkencash.</p>
Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>Institucioni dëshmon angazhim serioz të personelit ndihmës mësimor-shkencor me kohë të plotë, për realizimin e orëve laboratorike në auditor, mbikqyrjen e studentëve gjatë kryerjes së praktikës profesionale jashtë auditor dhe mirëmbajtjen e mjediseve laboratorike dhe shkollore. Kjo u konstatua gjatë vizitës në institucion të grupit të vlerësimit dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit shkresor.</p> <p>Personeli akademik, ndihmës dhe administrativ përmbush kriteret e kualifikimit dhe profesionalizmit sipas pozicionit të punës që kryhen dhe dëshmoi që ishte i angazhar në përmbushjen e objektivave të programit.</p> <p>Programi Bachelor në Infermieri përfshin praktika profesionale të cilat kryhen sipas programit kalendarik të miratuar nga senati i universitetit. Praktikrat profesionale të studentëve kryhen në institucionet shëndetësore publike</p>

	<p>ose jo publike më të cilat universiteti ka nënshkruar kontrata bashkëpunimi. Praktika profesionale organizohen në grupe nga 20-25 studentë të cilat drejtohen dhe mbikqyret nga SAE dhe një nga institucioni pritës.</p> <p>Pavarësisht numrit të lartë të studentëve, nuk u evidentuan problematika të zhvillimit të praktikave mësimore (refeuar dokumentacionit në dispozicion dhe takimit me studentët). Për këtë rast, ndjekja nga afër e zhvillimit të praktikave profesionale (<i>GVJ nuk e pati këtë mundësi për shkak të përfundimit të vitit akademik</i>), do të jepte një pamje më të qartë të realizimit të saj</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Institucioni deklaron se nuk kryhen programe specifike për kualifikimin profesional të stafit akademik por evente të ndryshme trajnimi.</p> <p>Të dhënat e programeve të studimit aktive miratohen çdo vit nga Senati akademik i institucionit.</p> <p>Dosja e programit ishte e depoazituar pranë departamentit</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Referuar gjetjeve dhe konstatimeve, rezultojnë se procedurat e ndjekura nga institucioni për rekrutimin e personelit janë në përputhje me legjislacionin. Kërkesat dhe kriteret për rekrutimin e stafit janë të sanksionuara në statutin dhe rregulloren e institucionit të miratuara nga strukturat drejtuese. 2. Personeli akademik, ndihmës akademik dhe administrativ përmbush kriteret e kualifikimit dhe profesionalizimit sipas pozicionit të punës që kryhen dhe dëshmoi që ishte i angazhar në përmbushjen e objektivave të programit. 3. Institucioni disponon bazë të dhënash për stafin akademik dhe ndihmës përfshirë dosjet individuale të tyre (CV, Informacioni mbi diplomat, kërkimin shkencor etj.) si dhe për shpërndarjen e ngarkesës mësimore vjetore. 4. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën 59% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimit bachelor në Infermieri i cili mbulon 77.2% të ngarkesës mësimore për vitin akademik 2018-19. Në disa raste u evidentua mbingarkesë e personelit akademik përtej parashikimeve të Udhëzimit 29, datë 10.09.2018. 5. Institucioni dhe njësia përkatëse vlerëson performancën e personelit akademik mbi bazë të dy indikatorëve, mësimdhënie dhe kërkim shkencor të përcaktura këto në kontratat individuale. Nuk ka një procedurë të përgjithshme për përcaktimin e detyrimeve akademike e administrative të personelit mbi bazën e së cilës të bëhet dhe vlerësimi i performancës së secilit pedagog. 6. Moshja e personelit akademik efektiv, në këtë program studimi është relativisht e re. Shumica e PAE janë të moshës nën 45 vjeç. 7. Drejtimi i lëndëve e moduleve realizohet nga titullarë të kategorisë profesor me përjashtim të dy lëndëve që janë me gradën “Doktorë shkencash”. 	

8. Institucioni nuk organizon programe specifike për kualifikimin profesional të stafit akademik.

4. **Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se Universiteti Privat “Albanian University” zotëron infrastrukturën e nevojshme (mjediset mësimore, infrastruktura fizike, teknologjia e informacionit, biblioteka, shërbimet për studentët) për zhvillimin e një procesi normal mësimor. Aktualisht departamenti i Infermierisë dhe fizioterapisë, zhvillon programin mësimor në ambiente që ndodhen në tre godina të ndryshme që janë në një distancë të shkurtër nga njëri tjetra. Ambientet janë të rikonstruara dhe përshtatura në klasa dhe laboratorë në funksion të programit të studimit.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore ka në dispozicion një sipërfaqe reth 4102 m², në të cilën përfshihen salla leksionesh dhe seminaresh, laboratorë, salla për praktikën lëndore, zyra për stafin, bibliotekë, librari, qendër internet, mjedise fotokopje, kafeteri etj. Në dokumentacionin shoqëruar të RVB është paraqitur planimetria e ndarjes dhe organizimit të ambienteve mësimore dhe ndihmëse të AU që u verifikuan. Institucioni disponon sistem ngrohje-ftohjes qendrore, sistemi i sigurimit pa ndërprerje të energjisë elektrike, nyjet hidrosanitare, sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit, sistem sigurie dhe vëzhgimi të ambienteve. GVJ vizitoi auditorët mësimorë të cilat ishin të pajisura me video-projektor, kompjuter të lidhur me internet dhe tabela, strukturën e nevojshme imobilare. Të gjitha ambiente mbulohen me rrjet internet ëireless i shfrytëzueshëm për stafin dhe studentët. Ndriçimi natyral dhe ai artificial ishte i bollshëm dhe i dedikuar për ambientet mësimore. Personeli akademik dhe administrativ kishte ambiente të mjaftueshme për punë dhe studim.

Institucioni disponon bibliotekë të paisur me 330 tituj librash në fushën mjekësore me reth 1314 kopje prej të cilave 145 tituj librash në fushën e infermierisë dhe fizioterapisë me reth 845 kopje. Vlen të theksohet pajisja e bibliotekës me botimet kryesore të fushës së mjekësisë të përkthyer në shqip. Biblioteka është e paisur me kompjutera dhe vënde leximi dhe qendron e hapur nga e hëna në të shtunë sipas orari të ekspozuar në ambientet e fakultetit. Në dispozicion të studentëve është dhe biblioteka online me drejtim mjekësor e aksesueshme në qendrën e internetit me asistencën e stafit të bibliotekës si dhe libraria e universitetit.

Stafi akademik dhe studentet e AU dispononin adresa të brendshme emaili, në dispozicion të studentëve funksiononte portali i studentit i aksesueshem përmes ëeb faqes au.edu.al. përmes të cilit studentët aksesonin të dhënat personale, rezultatet e provimeve si dhe informacione të tjera në funksion të procesit mësimor. Ajo çka u evidentua gjatë vizitës është përdorimi i disa sistemeve teknologjike për mësimdhënie, komunikim dhe ndërveprim me studentët por mungon një sistem i centralizuar informatik që mundëson jo vetëm komunikimin dhe informimin por edhe shërbime të tjera si akses në dokumentacionin elektronik të institucionit, edukim në distancë etj.

Në shërbim të procesit mësimor të studentëve të cilët ndjekin programin e studimit në infermieri janë në funksion laboratorë mësimore (laboratori i informatikës, histologjisë, anatomisë,

infirmierisë si dhe salla për praktikën lëndore). Gjatë vizitës në këto laboratorë GVJ vuri re që ato ishin të paisura me të gjitha aparaturat dhe mjetet e tjera të nevojshme për realizimin e procesit mësimor. Hapësirat fizike dhe pajisjet laboratorike ishin të përshtatshme dhe të mjaftueshme.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

Në të tre godinat ku zhvillohet programi mësimor më infermieri janë në dispozicion :

- Salla për leksione 14
- Klasa për seminare 14
- Salla për aktivitete promovuese 2
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale 22
- Laboratorë për lëndët 1
- Laboratorë informatike 2
- Salla interneti 2
- Salla për bibliotekë 2
- Mjedis për fotokopjime, librari etj 5
- Zyre informacioni për studentët 3
- Nyje hidrosanitare 20

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin 2
- Zyra për sekretarinë mësimore 4
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore 4
- Zyra për personelin akademik 4

Në dispozicion të procesit mësimor FSHM ka vënë një numër të mjaftueshëm ambiente dhe zyra për stafin akademik dhe atë të administratës, laboratorë klasa, auditorësh me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit si dhe mjedise të tjera ndihmëse.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se të dhënat e dosjes së vetëvlerësimit përputhen me gjendjen e konstatuar të ambienteve në dispozicion të programit të studimit si dhe në dispozicion të stafit. U vizituan dhe u verifikuan të gjitha ambientet në dispozicion të programit të studimit Bachelor.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;	Institucioni në funksion të programit mësimor siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse mjekësore të mjaftueshme në sasi dhe cilësi në gjuhën shqipe dhe të huaj të cilat gjenden në bibliotekën dhe librarinë e universitetit.
Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin	Biblioteka e AU pranë FSHM dispononte rreth 330 tituj

<p>për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>prej të cilave 145 në fushën e infermierisë dhe botime periodike në fushën e mjekësisë në ndihmë të procesit mësimor.</p> <p>Institucioni gjithashtu ka vënë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik bibliotekën online “cambrig journal”, “questia.com” dhe “textbook elsevier” për realizimin me sukses të programit të studimit dhe punës kërkimore shkencore.</p> <p>Gjatë vizitës në AU u deklarua nga përgjegjësi i departamentit se në fillim të cdo viti akademik në përputhje me programin e sylabuseve bëhen kërkesa për shtimin e librave të rinj në tituj dhe numër. Gjatë vitit 2018-2019 me kërkesë të stafit akademik dhe studentëve ishin siguruar dy traktate të reja në funksion të programit të infermierisë.</p> <p>Biblioteka kishte të afishuara oraret e shërbimit të cilat ishin në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>
---	--

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programe stimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe</p>	<p>Në dispozicion të procesit mësimor FSHM ka vënë një numër të mjaftueshëm laboratorësh, klasash, zyrash, auditorësh e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit.</p> <p>Pajisjet në mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje në plotë me qëllimet e programit. Të gjitha sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me videoprojektor, kompjutera, internet ëireless si dhe me të gjitha pajisjet e tjera të nevojshme.</p> <p>Laboratorët dhe sallat e praktikave profesionale përmbajnë aparaturat dhe të gjitha mjetet e tjera të nevojshme për plotësimin e kërkesave të programit të studimit.</p> <p>Në funksion të programit mësimor bachelor në infermieri janë katër laboratorë mjekësor si laborator anatomisë, infermierisë I dhe II, histologjisë si dhe salla për praktikën lëndore. Këto laboratorë kanë hapsira fizike, aparatura mjekësore dhe mjetet e tjera të nevojshme për realizimin e praktikave laboratorike dhe atyre profesionale.</p> <p>Për kryerjen e orëve të praktikës profesionale AU ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të shërbimit shëndetësor publik dhe privat parësor dhe spitalorë.</p>
--	---

subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.

Konkluzione të GVJ:

1. Universiteti ka siguruar infrastrukturën e nevojshme fizike në dispozicion të programit të studimit bachelor në infermieri. Këto ambiente lidhur me infrastrukturën ndërtimore kanë hapsira të mjaftueshme dhe të përshtashme për realizimin e programit Bachelor në infermieri.
2. Ambientet janë paisur me të gjithë paisjet e mjetet e duhura dedikuar zhvillimit të leksioneve, seminareve dhe orëve laboratorike(kompjutera, projektorë, internet etj).
3. Institucion disponon laboratore mesimore mjekësore dhe salla për praktikën profesionale të paisura me të gjithë aparaturat dhe paisjet mjekësore në funksion direkt të zhvillimit normal të programit mësimor.
4. Ambientet administrative janë të mjaftueshme për përmbushjen e kërkesave të stafit akademik e ndihmës dhe të studentëve.
5. Në funksion të procesit mësimor janë libraria dhe biblioteka të cilat janë të paisur me literaturë universitare në gjuhën shqip e në gjuhë të huaj. Gjithashtu në dispozicion të studenteve dhe stafit është dhe libraria elektronike.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Albanian University është një institucion i arsimit të lartë jo publik që financohet nga burimet e tij të brendshme të financimit. Në RVB raportohet se burimi i vetëm i financimit janë tarifat e studentëve. Këto të ardhura shpenzohen për shpenzime operative (qira, mirëmbajtje ambientesh, ngrohjen, shërbime interneti etj) si dhe për pagat e stafit akademik dhe atij administrative, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, shërbimet të tjera në funksion të programeve mësimore dhe detyrime ndaj shtetit. Gjithashtu një pjesë e fondit është përdorur për përmirësimin e infrastrukturës, investimit në laboratorë dhe auditore, shtimit të titujve në bibliotekë, proceseve të informatizimit, punësimin të stafit akademik të kualifikuar, financimit të veprimtarive shkencore. Të gjitha këto shpenzime janë të pasquruar në raportet financiare të institucionit të audituara dhe çertifikuar nga ekspertë të jashtëm .

Kosto vjetore e shërbimit ndryshon sipas programeve të ndryshme në bazë të veçorive të secilit program (për programin bachelor në Infermieri është 130000 lekë). Gjatë takimeve të realizuar në institucion, u deklarua se studentët përveç tarifës vjetore nuk paguajnë tarifa shtesë për ridhënie provimesh, praktika mësimore jashtë institucionit apo tarifa për shërbime administrative. Për studentët e ekselencës jepet dhe bursë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Grantet për kërkim- 0%
- Konsulencat, shërbimet -0%
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit -100% (144690000)
- Sponsorizimet-0%

- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)- 0%
- Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj -0%
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)- 0%

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Referuar RVB, kostoja për student varion nga një program në tjetrin. Kostoja është më e lartë në programet farmaci dhe stomatologji krahasuar me programet e tjera të studimit për shkak të numrit të vogël të studentëve në këto programe dhe bazës materiale të nevojshme të përdorur në këto programe. Në raport theksohet se tarifat për student janë të ulëta në raport me investimin në kushtet e mësimdhënies.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p>Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Cdo vit AU harton Projekt Buxhetin për vitin pasardhës ku merret parasysh edhe kostoja e hapjes së programeve të reja të studimit dhe që analizohet nga Bordi i Administrimit. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nuk është paraqitur raport i detajuar financiar që lidhet me programin e studimit, e kryer nga zyra e auditit të brendshëm ose të jashtëm (në raport deklarohet se institucioni ka ekspert kontabël që realizon auditimin e shoqërisë, si pjesë e zyrës së auditit të brendshëm, RVB, fq.28).</p> <p>Në raportin vjetor të vitit akademik 2017 – 2018 i përgatitur nga departamenti i infermierisë dhe fizioterapisë, ka të dhëna mbi financimin e disa aktiviteteve të personelit akademik dhe studentëve por nuk paraqiten të dhëna të ndara sipas zërave (pagesa të ndryshme, pagat e personelit, shpenzimet operative etj).</p> <p>Pavarësisht koston për student në programin e studimit prej 130000 lekësh të deklaruar, GVJ nuk disponon informacione mbi alokimin e shpenzimeve dhe llogaritjen e tyre.</p> <p>Programi nuk ka financime nga të ardhura të tjera projekte apo grante të ndryshme.</p>
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR	
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e</p>	<p>Institucioni harton raport financiar ku pasqyrohen në mënyrë të përgjithshme investimet, të ardhurat, shpenzimet, kostot e studentit etj, të hartuar nga ekspertë të jashtëm por që nuk janë përfshirë si pjesë e dokumentacionit të vlerësimit.</p>

burimeve financiare;

Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;

Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.

Institucioni deklaron se garanton qëndrueshmëri financiare dhe mundësi investimi në drejtim të përmirësimit të kushteve të kushteve të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor por e paverifikueshme nga ana e GVJ pasi nuk ka evidenca të qarta që paraqesin situatën financiare të institucionit në tërësi dhe të programit në veçanti. Nisur nga numri i studentëve dhe tarfia e shkollimit, financat për zhvillimin e këtij programi studimi, rezultojnë të shëndetshme

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Cdo vit AU harton Projekt Buxhetin për vitin pasardhës ku merret parasysh edhe kostoja e hapjes së programeve të reja të studimit.
2. Institucioni deklaron qëndrueshmëri financiare dhe mundësi investimi në drejtim të përmirësimit të kushteve të kushteve të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor por mungojnë të dhënat e sakta, raportet e auditimit, analiza financiare për të mbështetur këtë përfundim
3. Ka të dhëna financiare të pjesëshme të programit të studimit por që janë të pa mjaftueshme për të analizuar dhe gjykuar për ecurinë e programit dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të tij.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: *Institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njesisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.*

Referuar RVB rezulton se Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë në Albanian University është krijuar me Vendim të Senatit Akademik nr, 178 dt.23.07.2010, krahas kësaj njësie po me Vendim të Senatit Akademik nr. 4 dt. 22.12.2016 është krijuar Komisioni i përhershëm i Vlerësimit Institucional duke qënë kështu në përputhje edhe me kërkesat e ligjit 80/2015, Për Arsimin e Lartë në Shqipëri.

Gjatë vizitës në Insitucion dhe takimit me NJSBC GVJ-së ju be e ditur se kjo zyrë është në varësi të Rektorit (takimi me përfaqësuesit e NJSBC) dhe çdo fund viti përgatit një raport vjetor ku shprehen vlerësimit dhe informacionet në lidhje me kerkimin shkencor, mësimdhenin , shërbimin e ofruar nga personeli administrativ etj. Kjo njësi funksionon mbi bazë të rregullores së brendshme të Universitetit, më konkretisht nën 14 të kësaj rregulloreje. Referuar RVB, ecidencia 2.6 por edhe vizitës në Insitutcion GVJ konstaton se kjo zyrë përbëhet nga 6 antarë. NJSBC bën vlerësime periodike gjatë vitit akdemik, mbi bazë të të dhënave statsitkore që kjo zyrë mbledh gjatë anketimeve të studenteve, raporteve vjetore të pedagoqeve.

Në nivel institucional GVJ gjykon se SBC është i konsoliduar dhe zyra funksionon me kapacitet të plotë. Aktivitetet kryesore të NJSBC zhvillohen gjatë gjithë vitit akademik duke veçuar kontributin e saj veçanërisht në proceset e vlerësimit në kuadër të akreditimit (mbështetjen me dokumnte, hartimin e pjesëve të sigurimit të cilësisë në raportet e akreditimit apo informacione shitesë të kërkuara gjatë vizitave në kuadër të akreditimeve të programeve dhe institucionit).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:



Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit:

Sic u konfirmua dhe nga takimi me NJSBC gjatë vizitës në institucion, kjo zyrë realizon çdo vit akademik dy anketime me studentët, një për çdo semestër, anketimet realizohen në mënyrë anonime dhe para sezonit të provimeve, për vitin akademik 2018-2019, deri në momentin e që GVJ kryeu vizitën në Institucion rezultoi se studentët e këtij programi studimi kanë realizuar vetëm anketimin e semestrit të parë. Referuar RVB , pjesëmarrja në anketim nga studentet e programit të studimit Bsc Infermieri për semestrin e parë të vitit akademik 2018-2019 ishte 34% , kurse për sa i përket vitit akademik 2017-2018, pjesëmarrja në anketim e studentëve për semestrin e parë ka qënë 27% ose 201 studentë dhe për semestrin e dytë 30 % ose 223 studentë.

Bazuar në RVB dhe takimit me NJSBC GVJ konstaton se nga përpunimi i anketimeve të studentëve nuk kanë rezultuar problematika për sa i përket cilësisë së mësimdhënies dhe stafit akademik .

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Në Albanian University, Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë funksionon në nivel njësie bazë. Kështu në nivel departamenti, me asistencën e Zyrës së Kurrikulave, para çdo fillim viti të ri akademik, gjatë procesit të mësimdhënies, dhe në përfundim të tij analizohen dhe vlerësohen, programet mësimore, literatura dhe sistemet e vlerësimit.

NJSBC harton politikat e vetëvlerësimit dhe përcakton edhe kriteret e vlerësimit që do të ndiqen, bën të mundur hartimin e anketimeve dhe modeleve të raporteve vlerësuese, të cilat me tej iu shpërndahen Departamenteve dhe pas plotësimit të tyre prej studentëve ose pedagogeve. ZSBC bën përpunimin e të dhënave dhe nxjerr problematikën kryesore, përmirësimet që duhen kryer me qëllim përmirësimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, intervenimeve të të gjithë faktorëve përbërës të Universitetit.

Në përfundim të semestrit dhe vitit akademik njësisia bazë harton një raport vetëvlerësimi, ku përfshihen elementë të mësimdhënies, analizë programeve, stafi i rekrutuar, kalueshmëria e studentëve dhe rezultatet e arritura, veprimtaria shkencore dhe nëpërmjet një analize SËOT ndihmohet për përmirësimin e punës në të ardhmen. Ky raport i paraqitet Rektorit, i cili më tej e përfshin atë në rendin e ditës së Senatit Akademik për diskutim. Ky dokument nuk është vënë në dispozicion të GVJ por nga takimi me përfaqësues të zyrës, kjo procedurë kryhet.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti.

Gjatë vizitës në Institucion dhe takimit me NJSBC rezultoi se për monitorimin e cilësisë në nivel departamenti zyra bashkëpunon me Grupet e Sigurimit të Cilësisë që ka çdo departament, këto grupe funksionojnë si grupe ad hoc dhe janë të përbërë nga 2 ose 3 pedagogë të cilët në bashkëpunim edhe me lektorët e tjerë rishikojnë kurrikulat dhe syllabuset me qëllim përmirësimin e tyre.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;	Referuar evidences 6.3, GVJ konstaton se AU për matjen e ecurisë së programeve të studimit realizon anketime dy herë në vit me studentët. Nje mjet tjetër për matjen e

<p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); Dëgjime në auditor; Vlerësimi me nota/pikë; Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Etj. 	<p>cilësisë është dhe rishikimi i kurrikulave, syllabuseve cdo fillim viti si dhe formulari që plotësohet nga vetë stafi akademik, në të cilin ata deklarojnë realizimin e pritshmërive gjatë vitit akademik. Cdo fund semestri departamenti dorëzon një raport ku pasqyrohen vlerësimet dhe rezultatet e studentëve.</p> <p>Bazuar në RVB dhe evidencën 6.4 rezultoni së departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë në fund të vitit akademik përgatit një raport përmbledhës ku përfshihen të gjitha rezultatet vjetore që kanë lidhje me sigurimin e cilësisë, pas analizimit të këtij raporti bëhet një analizë krahasimore e të dhënave.</p> <p>Sic rezultoni edhe nga verifikimi i faqes zyrtare Eëb, AU në përfundim të cdo viti akademik publikon raportin vjetor të veprimtarisë mesimore dhe asaj kërkimore shkencore, duke e bërë atë transparente për publikun dhe për studentët e interesuar. Në zbatim të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë në shqipëri, ky raport i dërgohet më pas MASR.</p> <p>AU, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta si:</p> <p>Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; pyetje konceptuale;</p> <p>Teste të standardizuara kombëtare</p> <p>Dëgjime në auditor; Vlerësimi me nota/pikë;</p> <p>Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;</p> <p>Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët.</p> <p>Vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës;</p> <p>Informacioni i marë është përdorur për hartimin e vlerësimit të brendshëm, është bërë transparent edhe për studentët dhe stafin akademik.</p>
---	---

VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p>	<p>Referuar RVB rezultoni se AU është akredituar institucionalisht për një periudhë 2 vjetore me Vendim të Bordit të Akreditimit nr 90. Dt 20.10.2017.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p>	<p>AU për sigurimin e brendshëm të cilësisë ka si udhëzues manualin e sigurimit të brendshëm të cilësisë së bashku me standardet, miratuar nga ASCAL. SBC në nivel institucional është i konsoliduar dhe funksionon në përputhje me Kodin e cilësisë dhe udhëzuesit e ASCAL.</p>
<p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të</p>	

<p>qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>AU kryen në mënyrë sistematike vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodave të tërthorta, si p.sh në formën e sondazheve apo organizimit të pyetësorëve në internet me të gjithë studentët</p> <p>Nga vlerësimi i DVV rezultojnë se me anë të raporteve dhe pyetësorëve semestrale dhe vjetorë të vlerësimit AU ka një politikë të qartë dhe të konsoliduar për vlerësimin periodik të programeve të studimit.</p> <p>Cdo fillim viti akademik me anë të grupeve ad hoc të sigurimit të cilësisë të ngritura pranë cdo departamenti rishikohen syllabuset dhe literatura e tyre, duke u kujdesur që ajo të jetë e viteve të fundit e dhenë kjo që u konfirmua edhe nga biseda me NJSBC.</p> <p>Në javën e parë të cdo fillim viti akademik AU organizon takime orientuese me studentët dhe stafin akademik, në këto takime studentët informohen mbi statusin e programeve të studimit dhe njihen me rregulloren e AU, me të drejtat dhe detyrimet e tyre si dhe me ambjentet e Institucionit. Kurse sa i përket stafit akademik theksi bie mbi rëndësinë e akreditimit të programve të studimit dhe vlerësimin cilësor të tyre.</p> <p>Referuar Strategjisë së AU , GVJ konstaton se sigurimi i cilësisë është pjesë e përgjithshme e zhvillimit të AU. Gjithashtu rezultojnë se AU, harton politika, strategji dhe proceduara për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p>
---	---

Konkluzionet e vlerësimit:

1. AU ka të ngritur sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë dhe e ben funksional atë me anë të Zyrës së NJSBC.
2. NJSBC harton procedura për anketimin e studentëve dhe përmirësimin e mësimdhënies me anë të formulareve që plotësohen nga stafi akademik.
3. NJSBC harton raportë semestrale dhe vjetore ku përfshihen të dhëna mbi ecurinë e studentëve dhe punës kërkimore –shkencore të stafit akademik.
4. Rezultatet e anketimeve bëhen publike dhe janë objekt diskutimi në departement me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies.
5. NJSBC rezultojnë të ketë rol mjaft të rëndësishëm në proceset e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm në institucioni zhvillon




POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: *misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj*

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Infermieri” ofrohet nga departamenti “Infermieri dhe fizioterapi” në Fakultetin e Shkencave Mjekësore. Ky program është hapur në vitin 2011 me urdhër nr.411 datë 25.08.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës si pjesë e Fakultetit të Stomatologjisë. Në vitin 2013 me riorganizimin e njësive të “Fakultetit të Stomatologjisë” në “Fakultetin e Shkencave Mjekësore” me urdhërin Nr 196 datë 28.05.2013 Departamenti i infermierisë dhe fizoterapisë është njësi përbërëse e FSHM.

Ky program ka kaluar disa proçese akreditimi. Në vitin 2016, programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Infermieri”, u akreditua me kusht me vendimin Nr. 151 datë 31.03.2016 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe urdhërin Nr. 239 datë 9.05.2016 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Në vitin 2017 bordi i akreditimit vendosi heqjen e kushteve dhe akreditimin e programit të studimit me kohëzgjatje 2 vite akademike me vendim Nr 31 datë 19.05.2017.

Kurikula e programi të studimit është përmirësuar dhe përshtatur sipas legjislacionit në fuqi (Ligjin 80/2015 të arsimit të lartë si dhe akteve nënligjore të këtij ligji) dhe miratuar nga senatit i AU dhe urdhërin Nr.4932/1 datë 5.06.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Misioni, objektivat e programit të studimit, përmbajtja e tij, mënyra e organizimit, planet mësimore, sylabuset, literatura e rekomanduar, organizimi i provimeve etj. janë të përcaktuar në rregulloren e këtij programi, e cila u vu në dispozicion të GVJ gjatë vizitës në institucion. Ky program synon përgatitjen e studentëve me njohuri, aftësi e kompetenca të nevojshme profesionale teorike dhe praktike për realizimin e misionit të infermierit si dhe paisjen e tyre me njohuri në fusha specike të mjekësisë me qëllim orientimin e tyre në tregun e punës dhe krijimin e bazës së nevojshme të njohurive për specializime të mëtejshme.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, misioni i programit të studimit Bachelor në Infermieri është edukimi dhe formimi profesional i studentëve në infermieri që i përgjigjet nevojave bashkëkohore dhe kërkesave të tregut si dhe përfitimi i njohurive bazë dhe të nevojshme për zotërimin e kapacitetet dhe aftësive që duhet të ketë një infermier i përgjithshëm në përfundim të programit të studimit.

Objektivat e programit synojnë që në fund të studimeve, studentët e diplomuar të jenë të aftë të:

- Të zbatojnë në praktikë njohuritë bazë në shërbimin infermioror të fituar në këtë program studimi.

- Të përballen dhe përshtaten me kërkesat e tregut të punës.
- Zhvillojnë kreativitetin duke qenë inovativ në punën e tij dhe përdorimin me efikasitet të njohurive të fituara gjatë programit të studimit.
- Njohuritë e fituara në ciklin e parë të studime në Bachelor t'ju shërbejnë si bazë për trajnime të tjera në formimin e tyre të vazhdueshëm profesional.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Programi i studimit të ciklit të parë bachelor në infermieri është i organizuar në 3 vite akademike, 6 semestra, që kanë 90 javë mësimore në auditor dhe 180 ECTS në total.

- Një vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor të ndarë në dy semestra.
- Një semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- Numri total i krediteve të programit është 180 ECTS
- 1 orë mësimore – 50 minuta
- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit

Në përfundim të studimeve të ciklit të parë Bachelor në “Infermieri”, studentët pajisen me diplomë Bachelor, me emërtimin: Bachelor në Infermieri. Bazuar në Regullopren e Programit të studimit, diploma bachelor mbrohet me provim formimi ose punimin e një tezë diplome.

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë.

Plani mësimor sipas viteve akademike si dhe numri i ETC për lëndët e programit pasqyrohen në tabelën. 10 në aneks.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

Lëndët në program janë të vlerësuar në kredite të cilët përfaqësojnë orët mësimore në auditorë dhe punën e pavarur të studentit jashtë auditorit, ku 1 kredit është 25 orë mësimore. Programi mësimor është i organizuar në leksione, seminare, praktika laboratorike, praktika lëndore, praktikë profesionale dhe provimi përfundimtar.

Për këto kategori 1 ETC është vlerësuar në orë mësimore si vijon:

- | | |
|------------------------------|---|
| ▪ Për leksionet | 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Seminaret | 7.5-8 orë në auditor dhe 17-17.5 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Labororet | 23 orë në auditor dhe 2 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Praktikën lëndore | 25 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Praktikën Profesionale | 25 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Provimi përfundimtar | 0 orë në auditor dhe 25 orë punë e pavarur e studentit |

Për seminarët, ka lëndë që janë llogaritur 1 ECTS 8 orë në auditor dhe 17 orë punë e pavarur dhe lëndë me 1 ECTS 7.5 orë në auditor dhe 17.5 orë punë e pavarur.

Të dhënat e mësipërme janë paraqitur në RVB (fq34) por është e paqartë se si janë finalizuar këto raporte të shpërndarjes së ngarkesës mësimore për veprimtari formuese. Nga takimet me drejtuesit e njësive kryesore dhe bazë, u deklarua që këto raporte vendosen në bazë të programeve të studimit. Në mungesë të informacionit për njësite/programet e tjera të institucionit, GVJ gjykon se në nivel institucional institucioni duhet të hartojë një manual/ dokument i cili përcakton qartë raportet (në %, orë) të komponentëve mësimorë për 1 kredit për programe të ndryshme (profilin e programit, ciklin, fusha e studimit, lloji i lëndës/modulit, llojin e veprimtarive formuese etj)

Lëndët e porgramit janë kategorizuar sipas VKM Nr 41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” në lëndë bazë, karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore, lëndë plotësuese dhe detyrime të tjera plotësuese. Plani mësimor dhe sylabuset janë të hartuar në ECTS dhe orë mësimorë për çdo lëndë të programit. Raporti i lëndëve të përcaktuara në programin e studimit është: lëndë bazë (A) të cilat përbëjnë 19 % të totalit të ETC, lëndë karakterizuese të fushës (B) 52 %, lëndët ndërdisiplinore ose integruese (C) 12 %, lëndë plotësuese (D) 14% dhe detyrime përmbyllëse (E) 3 %.

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Tabela 12).

Kurikula e programit të ciklit të parë bachelor në infermieri e vitit të licensimit ka ndryshuar me vendim të senatit të AU në vitin 2018 dhe është miratuar urdhër nr.4932/1 datë 5.06.2018 të MASR.

Bazuar në VKM Nr 41 datë 24.01.2018 ndryshimi i krediteve është në masën 6%. Ndryshimet kanë konsistuar në futjen e më shumë orëve praktike në lëndët karakterizuese specifike.

Ndryshime janë bërë në kategorinë e lëndëve plotësuese ku gjuha e huaj nga 8 ETC është bërë 4ETC dhe është shtuar lëndë e re praktika profesionale 1 me 4 ETC. Ndryshimi tjetër është në lëndët karakterizuese ku obsterika dhe gjinekologjia nga 4 ETC secila janë bërë 3 ETC secila dhe këto 2 ETC i janë shtuar lëndës infermieristika në obsterikë gjinekologji e cila nga 3 ETC është bërë 5 ETC. Këto ndryshime në program janë bërë në favor të orëve të praktikës mësimore që i shërbejnë formimit praktik profesional të studentit si dhe përshtatjen më direktivat e BE.

Gjithashtu në funksion të saj është menduar hartimi i një moduli të përshtashëm vetëm për praktikën profesionale. Programi i studimit bachelor në infermieri është i përshtatur në masën 70% me programe të ngjashme të IAL të tjerë në vëndin tonë dhe masën 65-75% me normativat e BE. Vetë drejtuesit e njësive kryesore/bazë, ishin të paqartë se si do të shkohet në harmonizimin/përputhshmërinë e përmbajtjes së këtij programi me direktivat eurpiane të profesioneve të rregulluara edhe pse u deklarua që ka përpjekje për të riorganizuar programet e infermierisë në nivel kombëtar në përputhje me këto direktiva.

Për vitin akademik 2017-2018 programi mësimor është realizuar me kurikulën e vjetër për të tre vitet e studimit. Për vitin 2018-2019 viti i parë është me kurikulën e re, ndërsa dy vitet e tjera vazhdojnë me kurikulën e vjetër.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Tabela 13)

Personeli akademik që mbulon aktualisht programin Bachelor në “Infermieri” përbëhet nga staf specialist me kualifikim të lartë dhe përvojë në mësimdhënie. Pjesa më e madhe e stafit që mbulon lëndët karakterizuese të kategorise B, janë Mjekë Specialiste të fushave përkatëse dhe me kompetencë të lartë në këto fusha. Në këtë kategori lëndësh si dhë lëndët ndërdisiplinore të kategorisë C në katër-pesë raste fusha e ekspertizës së pedagogut nuk përputhet me sylabusin e lëndës të cilën zhvillon pedagogu duke ndikuar në cilësinë e mësimdhënies.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Emërtimi i lëndës/modulit

Në silabus janë të dokumentuar titulli i lëndës apo modulit për cdo lëndë, Tipologjia dhe kodi i lëndës.

Viti/semestri kur zhvillohet lënda

Në silabus është deklaruar qartë koha e realizimit të lëndës si viti akademik/semestri

• Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën

- Eshtë deklaruar emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën , adresa e tij e emailit si dhe titullari i lëndës.,
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Eshtë deklaruar qartë në sylabus vendi që ze lënda në formimin tërësor të studentit.
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Për secilën lëndë janë dhënë qartë kushtet për njohuritë paraprake.
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Në cdo sylabus ka një përmbledhje të aftësive, njohurive dhe kompetencave që lënda i jep studentit.
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
 - Tematikat janë përshkruar në mënyrë të detajuar sipas formave të mësimdhënies dhe orëve përkatëse për secilën temë. Në të gjithë sylabuset është zbatuar formati sipas vendimit Nr. 41, dt 24.1.2018 i MARS ku përfshihet dhe numri faqeve në literaturë.
 - Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
 - Në planin mësimor është dhënë numri i orëve në auditor dhe jashtë auditorit për secilën lëndë të programit studimor.
 - Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
 - Janë deklaruar format dhe metodat e mësimdhënies dhe raportet mes tyre.
- Format e vlerësimit të studentëve
 - Eshtë paraqitur mënyra e vlerësimit të studentëve shoqëruar dhe me sqarimet përkatëse.
- Detyrimet e studentit për lëndën
 - Në rregullore, në planin mësimor dhe në sylabuse janë përcaktuar detyrimet e studentit për lëndën.
 - Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse
 - Për cdo lëndë është deklaruar literatura e detyruar dhe literatura rekomaduese. Literatura e detyrueshme është në gjuhën shqipe.

Analizë e cilësisë së sylabuseve

Tematikat e sylabuseve janë në përgjithësi bashkëkohore dhe në përputhje me misionin dhe objektivat e programit të studimit. Sylabuset janë aprovuar nga Përgjegjësi i Departamentit dhe titullari i lëndës. Në të gjitha sylabuset përcaktohet titullari i programit i cili është më titullin profesor ose profesor i asociuar. Vetëm në dy raste titullari i programit ka gradën Doktorë shkencash. Sylabuset janë të ndërtuara sipas modelit të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.41, dt 24.1.2018 përfshirë dhe numrin e faqeve të literaturës për cdo teme. Për të gjitha lëndët e programit ka tekste dhe materiale plotësue në formë të shkruar apo prezantime në poëer point të përgatitura nga pedagogët e lëndës si dhe literaturën e detyrueshme dhe atë te rekomanduar. Literatura e detyrueshme është në gjuhën shqipe.

GVJ nga shqyrtimi i programit mësimor konstatoi se ka lëndë të cilat kanë përfshirë si orë mësimore projekte, orë të cilat nuk janë përfshirë apo cilësuar në sylabuset përkatëse.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion GVJ u konsultua me sylabuset e lëndëve, programet mësimore dhe gjatë intervistave me stafin akademik dhe drejtues të programit u diskutuan mekanizmat dhe ndryshimet periodike të kurikulave të programit për shtimin e orëve të praktikës për ta përafuar atë me direktivën Europiane.

Vlerësimi sipas Standardeve




Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Infermieri” është hapur më vitin 2011 me urdhër nr.411 datë 25.08.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Ky program ka kaluar disa procese akreditimi. Në vitin 2016, programi u akreditua me kusht me vendimin Nr. 151 datë 31.03.2016 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe urdhërin Nr. 239 datë 9.05.2016 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Në vitin 2017 bordi i akreditimit hoqi kushtet dhe akreditoi programin e studimit për 2 vite akademike me vendim Nr 31 datë 19.05.2017</p> <p>Programi është hartuar në zbatim të ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi mbi organizimin e programeve për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë dhe organizohet në lëndë/module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Një vit akademik përmban 60 kredite, në total 180 ETC për tre vitet e programit</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p>Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p>Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë,</p>	<p>Departamenti përgjegjës i programin e studimit bachelor në infermieri ka vënë në dispozicion informacionin e nevojshëm për programin e studimit ndërmjet faqes së ëebit ëebit ëëë.au.edu.al:</p> <p>Departamenti jep informacionin e nevojshëm për lëndët e detyruara, lëndët më zgjedhje, ngarkesën mësimore, frekuentimin, praktikat dhe orët laboratorike, kalendarin e procesit mësimor të ndarë në dy semestre për çdo vit akademik</p> <p>Para fillimit të lëndës/modulit çdo pedagog ju paraqet studentëve syllabusin e lëndës së bashku me modalitetet e përfshira në të për zhvillimin e mësimin. Informacioni i verifikua gjatë komunikimit me stafin dhe studentët.</p>

për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Programi është organizuar në përputhje me aktet ligjore në fuqi për arsimin e lartë. Ai realizohet në kohëzgjatje normale tre vite dhe 180 ECTS. Programi i studimit është në përputhje me misionin dhe objektivat specifikë të si dhe përshtatet me nevojat e tregut të punës..
2. Kurikula e programit të ciklit të parë bachelor, sipas deklarimeve të institucionit, ka pësuar ndryshime bazuar në VKM në masën 6%, të cilat janë miratuar nga senati universitetit dhe MASR.
3. Në planin mësimor është zbatuar në mënyrë të saktë shpërndarja e krediteve për forma të ndryshme të mësimdhënies (VKM 41).
4. Personeli akademik që mbulon aktualisht programin Bachelor në "Infermieri" përbëhet nga staf specialist me kualifikim të lartë dhe përvojë në mësimdhënie. Në disa raste fusha e ekspertizës së pedagogut nuk përputhet me sylabusin e lëndës që zhvillon pedagogu duke ndikuar në cilësinë e mësimdhënies.
5. Në funksion të rritjes së cilësisë dhe përafrimit të programit me direktivat e BE, GVJ sugjeron përmirësime periodike në program jo vetëm në funksion të shtimit të orëve të praktikës profesionale por edhe në përmbajtje të programit të studimiti (*Neni 31 i 2005/36/EC (për infermierët) dhe nenet 40-42 i 2005/36/EC për mamitë së bashku me anekset, përcaktojnë qartë principet bazë që duhet të plotësojë këto programe si dhe përmbajtjen që ato duhet të kenë.*)
6. Syllabuset janë në përputhje me misionin dhe objektivat e programit të studimit. Për lëndët e programit, ka tekste dhe materiale plotësue në formë të shkruar apo prezantime të përgatitura nga pedagogët e lëndë

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: *organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.*

Struktura e programit, forma e organizimit të mësimdhënie, plani mësimorë, kalendari akademik dhe mënyra e funksionimit të mësimdhënies, metoda e mësimdhënies, procedura e vlerësimit të studentëve janë të përcaktuar qartë në rregulloren e programit të ciklit të parë Bachelor në Infermieri, në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve/moduleve.

NJBSC kryhen në mënyrë periodike vlerësimin e procesit të mësimdhënies dhe stafit akademik nëpërmjet focus grupeve si dhe me anë të vlerësimit të pyetësorëve të studentëve.

Teknologjia, paisjet laboratorëve si dhe mjete didaktike që janë në funksion të procesit mësimor janë të mjaftueshme, cilësore dhe brenda standarteve bashkëkohore. Shpërndarja e orëve në bazë të formave të mësimdhënies është ndërtuar duke respektuar kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë dhe akteve të tjera ligjore në fuqi. IAL angazhohet në rritjet e cilësisë së mësidhënies duke nxitur mësimin interaktiv, punën në grup, realizimin e prezantimeve.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (Tabela 14).

<input checked="" type="checkbox"/>	Leksione	870
<input checked="" type="checkbox"/>	Seminare	346
<input checked="" type="checkbox"/>	Laboratore	91
<input checked="" type="checkbox"/>	Praktika lëndore	225
<input checked="" type="checkbox"/>	Praktikë profesionale	450
<input checked="" type="checkbox"/>	Projekte	23

Programi studimor ka parashikuar format e mësipërme të mësimdhënies. Orët totale në auditor dhe raportet për secilën lëndë të formave të ndryshme të mësimdhënies janë evidentuar në syllabuset e lëndëve/moduleve dhe në planin mësimor. Në planin mësimor llogariten 2005 orë totale në auditor..

Format e kontrollit të njohurive

Në syllabuset e çdo lëndë pasqyrohen qartë format e kontrollit të njohurive. Për vlerësimin përdoret sistemi shqiptar me nota nga 4 në 10 si me poshtë:

Piket	Nota	Gërma
Nota 4	1- 40	F
Nota 5	41-45	E
Nota 5	46-50	D-
Nota 6	51-55	D
Nota 6	56-60	D ₊
Nota 7	61-65	C-
Nota 7	66-70	C
Nota 8	71-75	C+
Nota 8	76-80	B-
Nota 9	81-85	B
Nota 9	86-90	B+
Nota 10	91-95	A-
Nota 10	96-100	A

Në syllabusin e lëndës përcaktohet edhe përqindja (pikëzimi) që zënë në vlerësimin total elementët e tjerë të kontrollit të dijeve si pjesëmarrja, detyrat, labororet, testimet gjatë vitit etj. Vihet re që mënyra e vlerësimit është e standartizuar, raportet e pikeve të marra nga provimi përfundimtar me pikët e marra nga forma të tjera vlerësimi janë të pasqyruar në syllabusin e lëndës dhe rregulloren e programit të studimit si në tabelën 15 në aneks.

Studimet mbyllen me provimin përfundimtar të diplomës dhe studentët me rezultate të larta mbrojnë temë diplome në mbyllje të studimeve.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njohurive

Aktivizimi i studentëve në projektet shkencore të institucionit dhe të pedagogëve është një nga detyrat e institucionit. AU organizon konferencën studentore me qëllim promovimin e punimeve që studentët kanë bërë në bashkëpunim me pedagogët e tyre në rang departamenti apo dhe jashtë tij. Gjitashtu studentët përfshihen në projekte shkencore në rang Departamenti apo programi

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion GVJ kishte në dispozicion programin mësimor, kalendari akademik, sylabuset e lëndëve, listën e pedagogëve të angazhuar në këtë program studimi, ngarkesa mësimore e tyre si dhe dokumenta të tjera lidhur me procesin e mësimdhënies.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: *procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve*

Procedurat e pranimit të studentëve

Bazuar në evidencën 1.1 (neni 10), dhe takimit me sekretarinë mësimore, rezulton se pranimi i studentëve në programin e studimit Bsc Infermieri kryhet konform ligjit 80/2015 për arsimin e lartë në shqipëri. Studentët të cilët duan të vazhdojnë studimet në programin e studimit Bsc Infermieri duhet të kenë mesatare mbi 6, dhe për tu regjistruar duhet të paraqesin fotokopje të një dokumenti identifikimi, deftesën e shkollës së mesme ose diplome tjetër e cila mund të jetë fituar jashtë vendit dhe e njësuar nga ministria e arsimit, sic u konfirmuan edhe nga takimi që GVJ pati me sekretarinë mësimore pranimi i studentëve në programin e studimit Bsc Infermieri behet në bazë të dosjes personale të çdo studenti. Referuar evidencës 1.1 nenit 12, programi i studimit të ciklit të parë Bsc Infermieri zhvillohet në tre vitë akademike ose 6 semestra. Studentët lejohen të zgjasin studimet e tyre për një afat maksimal prej 6 vitesh.

Referuar RVB, kriteret specifike të pranimit të studentëve në programin e studimit Bsc Infermieri janë, mesatarja e përgjithshme në masën 70 %, mesatarja e grup lëndëve në masën 30 %, më konkretisht për lëndët kimi, biologji, qytetari.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Bazuar në RVB dhe vizitën në sekretari, gjatë shqyrtimit të regjistrave themeltare rezulton se për vitin akademik 2018-2019 janë regjistruar për herë të parë 391 studentë me një mesatare 7.11, ndërsa për vitin akademik 2017-2018 rezultojnë të regjistruar për herë të parë 153 studentë me mesatare 7.01.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare (Tabela 17).

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend.

Referuar rregullores së programit të studimit evidencë 1.1 dhe rregullores së transferimeve evidencë 9.1, rezulton se AU disponon procedurë për transferimin e studentëve brenda të njëjtit cikël studimi midis programeve të njëjta ose të ngjashme. Bazuar në RVB GVJ konstaton se për vitin akademik 2017-2018 në këtë program studimi janë transferuar 26 studentë, ndërsa për vitin akademik 2018-2019 29 studentë, këto të dhëna u konfirmuan edhe gjatë takimit që GVJ pati me sekretarinë mësimore. Për pranimin e studentëve të transferuar nga insitucione të tjera drejt AU, insitucioni nge nje grup vlerësimi ad hoc i cili bën vlerësimin dhe sigurohet për respektimin e kushteve sipas rregullores së transferimeve.

Të dhëna për punësimin e studentëve

Bazuar në RVB, tabelën 18 por edhe në takimin me Zyrën e Karrierës për vitin akademik 2017-2018, rezulton se numri total i të punësuarve është 170 nga 310 studentë të diplomuar. Nga këta 170, 70 studentë janë punësuar në përputhje me diplomën e fituar në programin Bsc Infermieri dhe ndërsa 100 studentë janë punësuar jo në përputhje me diplomën e fituar nga ky program studimi.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëprirjes së studentëve të rinj.	
<p>Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e programit të studimit dhe në takimin me sekretarinë mësimore, GVJ konstaton se pranimet në ciklin e parë të studimit në departamentin e Infermierisë dhe Fizioterapisë zhvillohen sipas ligjit nr 80.2015, për arsimin e lartë në shqipëri.</p> <p>Nga shqyrtimi i DVV rezulton se përveç kriterit të mësatares 6, Insitucioni për këtë program studimi disponon kritere specifike për pranimin e studentëve sic janë mesatarja e përgjithshme dhe mesatarja e grup lëndëve Kimi, Biologji dhe Qytetari. Gjithashtu kusht për pranimin e studentëve në programin e studimit Bsc Infermieri është dhe paraqitja e dosjes personale të studentit e cila përmban fotokopje ID, Diplomën e maturës shtetërore të njësuar me origjinalin, certifikatën e notave apo diplome tjetër të njësuar nga ministria e arsimit.</p>
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p>Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe takimin me zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve si dhe në takimin me studentët rezulton se departamenti I AU organizon në javët e para të fillimit të vitit akademik takime informuese me studentët mbi programin e studimit, kohëzgjatjen e tij, mbi te drejtat dhe detyrimet që ata kanë etj.</p> <p>Ne fund të cdo semestri para provimeve, sic u konstatua dhe nga takimi me NJSBC studentët kanë mundësinë të vlerësojnë pedagogoet, infrastrukturën, stafin administrative, me an të anketimeve anonime që kryhen nga Zyra e Sigurimit të Cilesisë.</p> <p>Bazuar në Statutin e Insitucionit por dhe nga takimi gjatë vizitës në Insitucion me studentët e ketij programi studimmi, GVJ konstaton se AU ka të ngritur dhe funksionale Zyrën e Këshillimit të Karriereës e cila në bashkëpunim edhe me Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve, bejnë të mundur këshillimin e studentëve sa u perket mundësive të tyre të punesimit pas diplomimit, duke i informuar ata me</p>

	<p>broushura informuese, duke i dhënë informacion mbi mundësitë e punësimit dhe përshtatjene tyre me trgun e punës pas diplomimit etj. Me qëllim informimin e studentëve për mundësitë e punësimit dhe karrierën e tyre pas diplomimit, sic u konfirmua edhe nga takimi me studentët, AU i ve në dispozicion studentëve që në javën e parë të viti akademik, Udhëzuesin për Zhvillimin e Karrierës.</p>
<p>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Nga vizita në sekretarinë mësimore rezulton se AU mban statistika vjetorë për numrin e studentëve të regjistruar, atyre të diplomuar, studentët e transferuar, studentët që kanë ndërprerë studimet etj.</p> <p>Gjithashtu nga shqyrtimi i regjistrit të notave atij elektronik dhe hard copy, rezulton se AU ka të dhëna mbi ecurinë e studentëve të këtij programi studimi që nga fillimi i studimeve e deri në diplomimin e tyre.</p>
<p>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Referuar DVV dhe takimeve në Institucion rezulton se Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë monitoron ecurinë individuale të studentëve, ndërsa Qendra e Zhvillimit të Karrierës dhe e Këshillimit i orienton për zhvillimin e tyre profesional. AU ka të dhëna për përqindjen apo numrin e studentëve të punësuar gjatë përfundimit të programit të studimit të ciklit të parë</p> <p>Ky proces koordinohet ndërmjet Zyrës së Karrierës dhe Departamentit përkatës. Studentët informohen jo vetëm nga pedagogët, fletëpalosjet, broshurat, etj por edhe nga faqja e internetit e universitetit që pasurohet vazhdimisht në funksion të mirë të informimit dhe komunikimit me studentët e programit të studimit. Institucioni bashkëpunon me qendra të ndryshme spitalore, klinika për të realizuar praktikën profesionale, e cila zhvillohet në vitin e dytë dhe të tretë</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Pranimet e studentëve në programin e studimit Bsc. Infermieri bëhen në përputhje me ligjin 80/2015 për arsimin e lartë në Shqipëri. Institucioni deklaroi se përveç kriterëve të përgjithshme disponon edhe kriterë të vecanta për pranimin e studentëve por GVJ gjykon se numri i kuotave të pranimit është i lartë për këtë program studimi. 2. AU, me anë të Sekretarisë mësimore disponon të dhëna për ecurinë e studentëve që nga fillimi i studimeve e deri në diplomim. 	

3. Zyra e Karrierës dhe Zyra e Koordinimit të Studentëve, u ofrojnë studentëve informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit dhe me mundësitë e punësimit në tregun e punës pas diplomimit.
4. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë monitoron me anë të stafit administrativ dhe stafit akademik ecurinë e çdo studenti që ndjek këtë program studimi, duke i ardhur në ndihmë edhe për realizimin e praktikave profesionale.



KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor Pjesa përshkrimore

Terma reference: *politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.*

Referuar RVB dhe dokumentave mbështetës rezulton se Veprimtaria kërkimore – shkencore e AU priret, organizohet e zhvillohet në zbatim të ligjit nr. 9741, dt. 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Universiteti AU, për të realizuar botimet akademike në gjuhën shqipe të autorëve akademikë vendas apo të huaj, krijon dhe ve në funksionim njësinë e botimeve akademike. Institucioni ka revistën shkencore e universitetit “OPTIME” e cila mundëson botime të personelit akademik dhe studentëve

Aktualisht Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë nuk ka asnjë projekt të fituar dhe të realizuar. Nga takimi me përgjegjësen e departamentit u bë me dije se në vitet në vazhdim për të rritur sa më shumë cilësinë dhe profesionalizmin e tij Universiteti AU ka bërë përpjekje dhe po shqyrton mundësitë për të përfutur projekte të karaktereve të ndryshme, sipas nevojave të tregut të punës duke nxitur dhe angazhuar me tepër pedagogët e brendshëm që ai punëson.

Pedagogët nga ana e tyre kanë kontribuar me pjesëmarrje në konferenca dhe botime shkencore.

Në përputhje me organizimin e mësimdhënies Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë gjate viteve në vazhdim ka planifikuar e zhvillon konferenca studentore ,me referimin edhe të Pedagogëve përkatës, dhe vetë studentëve. Pedagogë të programit të studimit Bsc Infermieri kanë qenë të angazhuar në aktivitete shkencore në Universtitete të tjera partnere kombetare (evidenca 10.3), dhe ndërkombetare, dhe referimet e tyre kanë shërbyer si informacion edhe për studentet e vitit të parë, të dytë dhe të tretë.

Gjithashtu nga takimi me stafin akademik dhe me studentët rezulton se pedagogët u ofrojnë studentëve të reja shkencore të cilat i vlejné programit të lëndës dhe nuk janë pasqyruar në tekst, ose të reja të cilat mund të përmbysin një të dhënë e cila është në tekst i transmetohet studentit duke pasur parasysh nivelin e tij dhe sa do ti vlejë në të ardhmen.

Referuar RVB, GVJ konstaton se departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë ka organizuar disa konferenca studentore, ku mund të përmëndim konferencën e fundit të zhvilluar për vitin akademik 2018-2019 me temën “Shërbimi Shëndetësor në Sëmundjet e Brendshme”.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor

Referuar RVB , tabelës 19/a , 19/b dhe 20, si dhe takimeve të zhvilluara me stafin akademik gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se për vitin akademik 2018-2019 stafi akademik për këtë program studimi ka botuar artikuj në revistat ndërkombetare. Gjate këtij viti akademik për programin e studimit Bsc Infermieri Insitucioni ka organizuar 4 aktivitete shkencore.

Pavarësisht se niveli i studimit të këtij programi nuk kërkon angazhim të mirëfilltë shkencor, bie në sy angazhimi i ulët i njësisë përgjegjëse në lidhje me projektet kërkimore shkencore si dhe

mosfitimi i ndonjë projekti kërkimor në fushën e infermieristikës. Më së shumti, të dhënat e paraqitura në RVB, janë angazhime individuale të personelit akademik se sa një politikë e mirëfilltë mbështetëse në nivel institucional.

Më shume detaje për aktivitetin kërkimor shkencor të Insitucionit për këtë program studimi gjenden në tabelen nr 20.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Bazuar në RVB dhe DVV si dhe në takimin që GVJ realizoi me përgjegjësen e departamentit, rezulton se njësia kryesore dhe departamenti i Infermierise dhe Fizioterapisë ka lidhur marrveshje bashkëpunimi në fuksion të realizimit të programit të studimit Bsc Infermieri, me Universitete partnere kombëtare dhe ndërkombëtare por edhe me qendra spitalore për realizimin e praktikave të studentëve, për shkëmbimin e stafti akademik por edhe për realizimin e përbashkët të projekteve kërkimore shkencore, ndër këto marrveshje mund të përmendim atë me Universtietin Federico II të Napolit, Universitetin e Aquilas, Universitetin e Pisës, Institutim e Shëndetit Publik etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (Tabela nr 20 dhe 21)

Nga Shqyrtimi i DVV rezulton se Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi në rang kombëtar dhe ndërkombëtar, këto marrëveshje janë fokusuar kryesisht në pjesëmarrjen në aktivitete shkencore dhe prezantimi jashtë IAL po dhe jashtë vendit.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Tabela nr 21)

Nga shqyrtimi i DVV dhe tabelës 21 në RVB rezulton se Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me disa biznesë dhe Institucione të tjera të arsimit të lartë sic janë ato me disa Klinika mjekesore private, Qendra rehabilitimi, Spitale , Universitete ndërkombëtare etj. Këto marrëveshje janë lidhur në funksion të shkëmbimit të staftit, praktikave profesionale të studentëve , kërkimit shkencor, punësimit të studentëve pas përfundimit të studimeve etj.

Nga analiza e të gjithë informacioneve të vëna në dispozicion, vërehet një numër i lartë marrveshjes bashkëpunimi në nivel institucional çka konisderiohet mjaft pozitive nga ana e GVJ. Megjithatë nuk ka një analizë të detajuar mbi produktin apo efektshmërinë e këtyre marrveshjeve. Fakulteti duhet të analizojë përfitimet për institucionin nga secili bashkëpunim për të parë vijueshmërinë ose jo në të ardhmen. Kjo do të ndihmojë institucionin të kërkojë bashkëpunorë dhe partnerë të rinj në funksion të zhvillimit e përmirësimit të programit të studimit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
---------------------	-------------------------



**VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI,
TË BRENDSHME DHE TË JASHTME**

Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.

Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;

Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.

Nga vizita në Insitucion por edhe nga shqyrtimi I DVV, GVJ konstaton se ka një bashkëpunim të frytshëm midis strukturave të insitucionit në drejtim të kërkimit shkencor mësimdhënies dhe informimit të studentëve.

Referuar Statutit dhe Rregullurës se Fakultetit rezulton se në AU detyrat e stafit janë të percaktuara qartë dhe secila nga zyrat raporton rregullisht në instancat vartëse.

Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.

Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;

Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;

Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;

Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

Referuar Tabelës 21 në RVB dhe takimit që GVJ realizoi me studentët e programit të studimit, rezulton se për realizimin e programit të studimit AU ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me spitale dhe klinika private.

Referuar DVV, evidencës 3.14 , GV konstaton se në marrëveshjet e bashkëpunimit dhe në insitucionet ku AU dergon studentë për realizimin e praktikave, përcaktohet një udheheqës i cili i cili informon AU mbi mbarevjetjen e saj. Gjithashtu në vijim të këtij bashkëpunimi me kompanitë punëdhënëse bazuar në evidencën 11.2 dhe 11.3 në DVV ,rezulton se AU organizon trajnime të ndryshme për kualifikimin e stafit akademik dhe atij administrativ. Në fund të cdo viti akademik zyrat përkatëse të AU hartojnë një raport mbi përfitimet e këtyre bashkëpunimeve dhe marrveshjeve sic tregohet dhe në evidencën 11.3 në DVV.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Vlersohet pozitiv angazhimi i institucionit në lidhjen e marrveshjeve të ndryshme bashkëpunimi me Qendra Spitalore, Klinka Private dhe Universitete Kombëtare dhe Ndërkombetare në kuadër te realizimit të praktikave profesionale te studetëve por edhe te shkëmbimit të stafit.
2. Nuk ka një analizë të detajuar mbi produktin apo efektshmërinë e këtyre marrveshjeve. Fakulteti duhet të analizojë përfitimet për institucionin nga secili bashkëpunim për të parë vijueshmërinë ose jo në të ardhmen. Kjo do të ndihmojë institucionin të kërkojë bashkëpunorë dhe partnerë të rinj në funksion të zhvillimit e përmirësimit të programit të studimit.
3. Personeli akademik i departamentit të Infermirise dhe Fiziotherapisë është anagazhuar në konferenca të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.
4. Struktura organizative e AU, zyrat përbërëse të saj bashkëpunojnë më njëra tjetren në funksion të realizimit të programit të studimit dhe informimit të studentëve sa i përket praktiva profesionale dhe kërikimit shkencor të stafit.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Programi i studimit fillimisht është akredituar me kusht duke i lënë detyrë institucionit të plotësojë një sërë kushtesh (të paraqitura në VKA. Nr.151, datë 31.03.2016). Pas procesit të vlerësimit në kuadër të plotësimit të kushteve (follow-up) dhe raportit teknik të hartuar në përfundim të procesit, (datë 05.05.2017), rezulton se institucioni ka përbushur kushtet e vëna. Bazuar në Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr 31, datë 19.05.2017, nuk rezultojnë kushte të vëna për plotësim me afat apo pa afat dhe në këto kushte GVJ gjykon se institucioni nuk ka detyrime apo kushte për të plotësuar nga akreditimi i mëparshëm.

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SËOT (STRENGTHS- PIKAT E FORTA, ËEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES- MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

1. Programi Bsc Infermieri është në përputhje me strategjinë e institucionit dhe kërkesat e tregut të punës. Nisur nga eksperiencia disa vjeçare, programi i është i konsoliduar në indikatorët e përgjithshëm të zhvillimit të tij.
2. Veprimtaritë formuese ofrohen në përputhje me planin mësimor dhe nga personel akademik me tituj e grada të cilët tregojnë interes në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies.
3. Numër i madh partnerësh dhe bashkëpunime me qendra të ndryshme spitalore private dhe shtetërore për realizimin e praktikave të studentëve.
4. Infrastruktura bashkëkohore për realizimin e procesit të mësimdhënies.

b. Pika të dobëta:

1. Disa lëndë mbulohen nga pedagogë të cilet nuk janë specialistë të fushës që ata mbulojnë dhe në disa raste evidentohet mbingarkesë e personelit akademik.
2. Mungon një studimi i detajuar nga ana e Njësisë Kryesore për programin në lidhje me situatën aktuale të programit, zhvillimet dhe kërkesat e tregut të punës si dhe hartimi i një plani strategjik të zhvillimit të programit në raport me zhvillimet brenda dhe jashtë vendit.
3. Numer i ulët i projekteve në nivel institucional në fushën e infermieristikës (kombëtare dhe ndërkombëtare) si dhe angazhim i ulët i personelit akademik dhe studentëve në projekte bashkëpunimi dhe mobiliteti.

c. Mundësitë:


1. Përmirësimi i vazhdueshëm i kurrikulës në përputhje me direktivat evropiane.
2. Zgjerimi i bashkëpunimeve kombëtare dhe ndërkombëtare.
3. Rritja e numrit të aplikimeve për projekte kërkimore shkencore, me qëllim rritjen e shanseve për fitimin e tyre.
4. Kërkesa gjithnjë në rritje për të diplomuar dhe profesionistë të këtij programi, veçanërisht nga tregu ndërkombëtar i punës.

d. Pengesat:

1. Konkurenca nga insitucione të tjera të arsimit të lartë.
2. Emigrimi i të diplomuarëve jashtë vendit, e bën të vështirë rekrutimin cilësor të stafit të ri akademik.
3. Numri i lartë i studentëve (kuotave) mund të ndikojë në të ardhmen në zhvillimin cilësor të veprimtarive formuese dhe praktikave profesionale.

Rekomandime:

1. Insitucioni të marrë masa për rekrutimin e stafit të profilizuar në lëndët që mbulohen nga pedagogë të cilët nuk i përkasin atij specialiteti dhe të sigurojë shpërndarje normale të ngarkesës mësimore në përputhje me Udhëzimin nr.29, datë 10.09.2018 të MASR.
2. Njësia përgjegjëse të ndërmarë një studim në lidhje me situatën aktuale të programit, zhvillimet dhe kërkesat e tregut të punës për të ndihmuar studentët në punësim si brënda ashtu dhe jashtë vendit.
3. Institucioni të hartojë një dokument strategjik afatgjatë për zhvillimin e programit në raport me ofertat e reja të punësimit.
4. Njësia përgjegjëse të fokusohet më shumë në hartimin dhe pjesëmarrjen në projekte apo bashkëpunime për të siguruar mundësi të tjera financimi për garantimin e ecurisë afatgjatë të programit të studimit.
5. Personeli akademik duhet të angazhohet në mënyrë të vazhdueshme në projekte, studime dhe mobilitete jashtë vendit



SUMMARY ANALYSES OF THE STUDY PROGRAM EVALUATION

I. ANALYSIS OF FULFILLING THE RECOMMENDATIONS GIVEN BY THE ACCREDITATION BOARD IN THE DECISION OF THE FIRST ACCREDITATION

The study program is initially accredited with a set of conditions (as presented in CAD No.151, dated 31.03.2016), leaving to the institution the task of fulfilling these conditions. Following the evaluation process in the context of the follow-up and the technical report drafted at the end of the process (dated 05.05.2017), it results that the institution has fulfilled the conditions. Based on the Accreditation Board Decision No. 31, dated 19.05.2017, the EEG considers that the institution has no obligations or conditions to fulfill from the previous accreditation.

II. SUMMARY ANALYSIS OF EXTERNAL EVALUATION GROUP BY SWOT METHOD (Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats).

a. Strengths:


1. The study program Bsc "Nursing" is in line with the institution's strategy and labor market requirements. Based on several years of experience, the program is consolidated into general indicators of its development.
2. Formative activities are provided in accordance with the curriculum and by academic staff with titles and degrees who shows an interest in continually improving the quality of teaching.
3. Large number of partners and collaborations with various private and public hospital centers for the realization of students internships.
4. Modern infrastructure for the realization of the teaching process.

b. Weaknesses:

1. Some subjects are covered by professors who are not specialists of the field they cover and in some cases academic staff is overloaded.
2. There is a lack of detailed study by the faculty on the current program situation, developments and labor market needs as well as the designation of a strategic program development plan in relation to country and abroad developments.
3. Low number of projects at institutional level in the field of nursing (national and international) as well as low engagement of academic staff and students in cooperation and mobility projects.

c. Opportunities:

1. Continuous improvement of the curriculum in line with European directives.
2. Expanding national and international cooperation.
3. Increasing the number of applications for scientific research projects in order to increase the chances of winning them.



4. The increasing demand for graduated and professionals of this program, especially from the international labor market.

d. Threats:

1. Competition from other higher education institutions.
2. The migration abroad of graduated students makes the recruitment of new academic staff difficult.
3. The high number of students (quotas) may in the future influence the qualitative development of training activities and professional practices.

Recommendations:

1. The institution should take into consideration the recruitment of academic staff profiled in subjects covered by professors who do not belong to that specialty and to ensure a normal distribution of teaching load in accordance with MoESY Instruction No. 29, dated 10.09.2018.
2. The department, responsible the study program, should undertake an analyse of the program's current situation, developments and labor market requirements, to assist students in employment both domestically and abroad.
3. The insitution should design a long-term strategic document for program development in relation to new job offers.
4. The responsible unit should focus more on designing and participating in projects or collaborations to provide other funding opportunities to guarantee the long-term progress of the study program.
5. Academic staff should be constantly engaged in projects, studies and mobility abroad.

External Evaluation Group

Prof.As. Vjolca Durro

Dr. Niko Hyka

